



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:156726
Datë: 20.08.2024
Numri i dokumentit: 06068311

APS.nr.5/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti Special – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vaton Durguti kryetar i kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Afërdita Bytyqi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarve E.B, V.B dhe B.V për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 dhe par.1 dhe lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarve E.B, XH.A, B.V dhe V.O për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga neni 32 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit në bashkëkryerje lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e ushtruara nga e akuzuara E.B dhe mbrojtësi i saj av.Liridon Tafa, V.B, av.Murat Demoll, B.V, av.Fanol Krasniqi, XH.A, av.Naim Rudari dhe V.O, av.Ramiz Krasniqi, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.60/2023 i datës 19.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e ushtruara nga e akuzuara E.B dhe mbrojtësi i saj av.Liridon Tafa, V.B, av.Murat Demoll, B.V, av.Fanol Krasniqi, XH.A, av.Naim Rudari dhe V.O, av.Ramiz Krasniqi, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.60/2023 i datës 19.10.2023, **VËRTETOHET**.

Arsy etimi

Historiku procedural

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.60/2023 të datës 19.10.2023, të akuzuarit E.B, V.B dhe B.V për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 dhe par.1 dhe lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, si dhe të akuzuarit E.B, XH.A, B.V dhe V.O për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga neni 32 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit në bashkëkryerje lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, i ka shpallur fajtor dhe ka gjykuar si në vijim: Të akuzuarën E.B për veprën penale si në pikën I të dispozitivit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 20.000 (njëzetë mijë euro), ndërsa për veprën penale si në pikën II të dispozitivit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 2 (dy) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 100.000 euro (njëqindmijë euro).

Konform nenit 80 të KPRK-së të akuzuarës i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vite, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 120.000 (njëqind e njëzetë mijë euro).

Në dënimin me burgim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.15.05.2014 deri me dt.15.05.2015, koha e kaluar në paraburgim nga dt.15.06.2022 e gjer me dt.16.05.2023, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.16.05.2023 gjet me dt.19.10.2023, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 muaj nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në qoftë se e akuzuara dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, gjykata do të ia zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim duke ia llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkaloj 3 vite.

Është obliguar e akuzuara që të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 500€, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200€, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50€.

Të akuzuarit B.V për veprën penale si në pikën I të dispozitivit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 10.000 (dhjetëmijë euro), ndërsa për veprën penale si në pikën II të dispozitivit i ka shqiptuar dënim me burgim në

kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 2 (dy) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 50.000 euro (pesëdhjetëmijë euro).

Konform nenit 80 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 60.000 (gjashtëdhjetë mijë euro).

Në dënimin me burgim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.15.06.2022 deri me dt.16.05.2023, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.16.05.2023 deri me dt.19.10.2023, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 muaj nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykit. Në qoftë se i akuzuari dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, gjykata do të ia zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim duke ia llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkaloj 3 vite, si dhe është obliguar i akuzuari që të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 500€, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200€, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50€.

Të akuzuarit V.B për veprën penale si në pikën I të dispozitivit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 10.000 (dhjetëmijë euro). Në dënimin me burgim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga dt.15.05.2014 deri me dt.14.10.2014, koha e kaluar në paraburgim nga dt.15.06.2022 deri me dt.16.05.2023, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.16.05.2023 deri me dt.19.10.2023, i cili dënim me burgim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 muaj nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykit. Në qoftë se i akuzuari dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, gjykata do të ia zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim duke ia llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkaloj 3 vite, si dhe është obliguar i akuzuari që të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 500€, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200€, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50€.

Të akuzuarit XH.A për veprën penale si në pikën II të dispozitivit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 50.000 (pesëdhjetëmijë euro). Dënimi me burgim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 muaj nga data

e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit. Në qoftë se i akuzuari dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, gjykata do të ia zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim duke ia llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkaloj 3 vite, si dhe është obliguar i akuzuari që të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumë prej 200€, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 120€, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 50€.

Ndërsa të akuzuarit V.O për veprën penale si në pikën II të dispozitivit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 50.000 (pesëdhjetëmijë euro). Dënimi me burgim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 muaj nga data e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit. Në qoftë se i akuzuari dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, gjykata do të ia zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim duke ia llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkaloj 3 vite, si dhe është obliguar i akuzuari që të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumë prej 200€, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 120€, si dhe në emër të kompenzimit të viktimave të krimit shumë prej 50€.

Të akuzuarit V.O i konfiskohet trualli në fshatin Ll.... Komuna e Prishtinës në sipërfaqe prej 5 ari (500m²) sipas certifikatës së pronësisë P-71914075-01273-6.

Të akuzuarit E.B, B.V, V.B, XH.A dhe V.O obligohen që në mënyrë solidare dhe nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë të paguajnë dëmshpërblimin në lartësinë e pagesave të bëra të dëmtuarve dhe atë:

1. A.D shumë prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
2. A.G shumë prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
3. A.V shumë prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
4. A.M shumë prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
5. A.G shumë prej 2,500 (dymijë e pesëqindë) euro,
6. A.H shumë prej 10,300 (dhjetë mijë e treqindë) euro,
7. A.M shumë prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
8. A.H shumë prej 11,7000 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqindë) euro,
9. A.B shumë prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
10. A.K shumë prej 10,600 (dhjetë mijë e gjashtëqind) euro,

11. A.K shumën prej 11,640 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) euro,
12. A.S shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
13. A.M-K shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
14. A.Q shumën prej 17,070 (shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë) euro,
15. A.M shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
16. B.S shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
17. B.G shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
18. B.P shumën prej 16,100 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind) euro,
19. B.S shumën prej 12,000 (dymbëdhjetë mijë) euro,
20. B.SH shumën prej 12,600 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro,
21. B.H shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro,
22. B.K shumën prej 31,950 (tridhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) euro,
23. D.B shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
24. D.B shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
25. D.L shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
26. D.O shumën prej 21,300 (njëzetë e një mijë e treqind) euro,
27. E.V shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
28. E.U shumën prej 10,340 (dhjetë mijë e treqind e katër dhjetë) euro,
29. E.K shumën prej 3,900 (tre mijë e nëntë qind) euro,
30. E.XH shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
31. E.S shumën prej 26,000 (njëzetë e gjashtë mijë) euro,
32. F.K shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
33. F.SH shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
34. F.Z shumën prej 14,500 (katërmbëdhjetë mijë e pesëqind) euro,
35. F.G shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
36. F.D shumën prej 10,180 (dhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë) euro,
37. F.H shumën prej 10,822 (dhjetë mijë e tetëqindën e njëzetë e dy) euro,
38. F.H shumën prej 24,000 (njëzetë e katër mijë) euro,
39. F.ZH shumën prej 6,000 (gjashtë mijë) euro,
40. F.E shumën prej 5,000 (pesë mijë) euro,
41. F.E shumën prej 5,171 (pesë mijë e njëqindë e shtatëdhjetë e një) euro,
42. G.N shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
43. G.M shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
44. G.H shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,

45. H.K shumën prej 12,000 (dymbëdhjetë mijë) euro,
46. H.D shumën prej 13,000 (trembëdhjetë mijë) euro,
47. H.TH shumën prej 12,550 (dymbëdhjetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) euro,
48. I.K shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
49. I.G shumën prej 5,000 (pesë mijë) euro,
50. I.K shumën prej 5,000 (pesë mijë) euro,
51. I.H shumën prej 11,400 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind) euro,
52. I dhe L.B shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
53. I.H shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
54. I.R shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
55. K.T shumën prej 10,412 (dhjetëmijë e katërqind e dymbëdhjetë) euro,
56. J.D shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
57. J.P shumën prej 10,400 (dhjetë mijë e katërqind) euro,
58. L.P shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
59. L.D shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
60. L.A shumën prej 6,000 (gjashtë mijë) euro,
61. L.SH shumën prej 46,150 (katërdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e pesëdhjetë) euro,
62. M.K shumën prej 16,34.60 (gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e katër dhjetë e një euro e gjashtëdhjetë cent),
63. M.B shumën prej (dymbëdhjetë mijë e katërqind) euro,
64. M.S shumën prej 8,000 (tetë mijë) euro,
65. M.C dhe I.A shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
66. L.E dhe M.S.E shumën prej 26,500 (njëzet e gjashtë mijë e pesëqind) euro,
67. M.G shumën prej 11,771 (njëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një) euro,
68. M.K shumën prej 6,440 (gjashtëmijë) euro,
69. M.H shumën prej 7,500 (shtatëmijë e pesëqind) euro,
70. M.B shumën prej 20,000 (njëzetë mijë) euro,
71. N.LI shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro,
72. N.M shumën prej 5,840 (pesëmijë e tetëqind e katër dhjetë) euro,
73. N.S shumën prej 31,000 (tridhjetë e një mijë) euro,
74. N.P shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
75. N.D shumën prej 20,000 (njëzetë mijë) euro,
76. N.LI shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
77. P.L shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,

78. Q.K shumën prej 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë) euro,
79. Q, J dhe R.B shumën prej 34,000 (tridhjetë e katër mijë) euro,
80. Q.R shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
81. R.K shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
82. R.M shumën prej 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro,
83. R.S shumën prej 12,000 (dymbëdhjetë mijë) euro,
84. R.B shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
85. K.G shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
86. S.SH shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
87. S.Z shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
88. S.H shumën prej 43,000 (katër dhjetë e tre mijë) euro,
89. S.S shumën prej 2,000 (dy mijë) euro,
90. S.Sh shumën prej 7,000 (shtatë mijë) euro,
91. S.M shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
92. S.M shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
93. Sh.S shumën prej 11,200 (njëmbëdhjetë mijë) euro,
94. Sh.K shumën prej 12,800 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind) euro,
95. Sh.Sh shumën prej 25,000 (njëzetë e pesë mijë) euro,
96. Sh.P shumën prej 12,200 (dymbëdhjetë mijë e dyqind) euro,
97. Sh.K shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
98. Sh.A shumën prej 8,000 (tetë mijë) euro,
99. S.B shumën prej 11,500 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) euro,
100. E dhe S.F shumën prej 11,400 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e kartë dhjete) euro,
101. S.Xh shumën prej 8,000 (tetë mijë) euro,
102. S.S shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
103. T.P shumën prej 17,500 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) euro,
104. T.P shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
105. V. K shumën prej 14,500 (katërmëdhjetë mijë e pesëqind) euro,
106. V dhe A.I shumën prej 18,300 (tetëmbëdhjetë mijë e treqind) euro,
107. V.D shumën prej 11,000 (njëmbëdhjetë mijë) euro,
108. V.S shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
109. V.L shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro,
110. V.M shumën prej 10,600 (dhjetë mijë e gjashtëqind) euro,
111. Xh.S shumën prej 17,292 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) euro,

- 112.Xh.B shumën prej 17,376 (shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) euro,
113.Xh.K shumën prej 32,500 (tridhjetë e dy mijë e pesëqind) euro,
114.Xh.Xh shumën prej 5,000 (pesë mijë) euro,
115.Z.P shumën prej 6,500 (gjashtë mijë e pesëqind) euro,
116.Z.F.J shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
117.Z.H shumën prej 8,000 (tetë mijë) euro.

Përtej shumës së gjykuar palët e dëmtuara të cekura më lartë udhëzohen në kontest civil.

Të dëmtuarit V.I, I.I, S.B dhe N.B, V dhe R.H, S.B, F.M, F.Xh, H.K, H.H, D.H të paraqitur në aktakuzë si të dëmtuar, udhëzohen në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarës E.B, av.Liridon Tafa, dhe e akuzuara për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar ta anuloj, ashtu që e akuzuara të lirohet nga akuza, apo çështjen ta kthejë në rigjykim.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.B, av.Murat Demolli, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, si dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj, duke e liruar të akuzuarin nga aktakuza, apo i njëjti të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.V, av.Fanol Krasniqi për shkak të shkeljeve absolute të dispozitave ligjore të KPPRK, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal në dëm të akuzuarit, si dhe vendimit për dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta lirojë nga akuza në mungesë të provave, apo të njëjtin aktgjykim ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe në rigjykim të përjashtohet kryetarja e trupit gjykues.

Mbrojtësi i të akuzuarit XH.A, av.Naim Rudari për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, shkeljes së ligjit penal neni 385 të KPPRK-së dhe vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike neni 386 të KPP-së, me propozim që

Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën si të bazuar në tërësi, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj, ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza e cila nuk përmban dyshimin e bazuar mirë, apo çështjen ta kthej të rigjykim dhe rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.O, av.Ramiz Krasniqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore të KPPK-së, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal në dëm të akuzuarit, si dhe vendimit të gabuar për dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj, dhe të akuzuarin ta liroj nga aktakuza.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/I.nr.82/2024, të datës 06.02.2024, ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve E.B, XH.A – av.Naim Rudari, B.V – av.Fanol Krasniqi, V.O – av.Ramiz Krasniqi, dhe V.B – av.Murat Demolli, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën ka prezantuar i dëmtari N.B, të akuzuarit E.B, V.B dhe B.V dhe XH.A, si dhe mbrojtësit e tyre, av.Liridon Tafa, av.Murat Demolli, av.Fanol Krasniqi, av.Naim Rudari dhe Ramiz Krasniqi, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit të dëmtuarit S.B, V. dhe R.H, S.B, F.M, F.Xh, H.K, H.H, D.H dhe i akuzuari V.O. Në seancën e kolegjit i dëmtuari N.B në deklarinimin e tij thekson se i bashkëngjitet ndjekja penale dhe ushtron kërkesë pasurore juridike me kamatë vjetore prej 8%.

Mbrojtësi i të akuzuarës E.B, av.Liridon Tafa në deklarinimin e tij thekson se mbetet në tërësi pranë ankesës me shkrim dhe thirret në kërkesën e cila nuk ka vendosur lidhur me gypin se sa ndërtesa ka drejt ti ndërtoj, pra prova e Komunës së Prishtinës dhe Ujësjellësit të cilat shkuan në favor të mbrojturës time por gjykata e ka marrë në dëm, me propozim që ankesa të aprovohet.

E akuzuara E.B deklaron se mbetem në tërësi pranë ankesës së ushtruar me shkrim dhe i mbështes fjalët e avokatit dhe shton se unë nuk e kamë nis këtë punë me mashtrim apo shpërlarje të parave, jam e gatshme me e vazhdu punën dhe të jua kthej parat. Nuk i mohon askujt obligimet por shtonë se nuk kam mundur me i përfundu ndërtimet dhe obligimet sipas kontratave për shkak se kamë qenë në burg.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.B, av.Murat Demolli në deklarinimin e tij thekson se mbetem në tërësi pranë ankesës së bërë me shkrim dhe shtonë se nuk janë eliminuar shkeljet si në vendimin e anuluar, si dhe thirret në Kodin e vjetër dhe Kodin e ri, dhe propozon që e njëjta ankesë të

aprovohet në tërësi, ndërsa i akuzuari V.B deklaron se i përkrahë në tërësi thëniet e mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuari B.V, av.Fanol Krasniqi në deklarimin e tij thekson se mbetem në tërësi pranë ankesës së bërë me shkrim dhe shtonë se aktgjykimi i referohet vetëm personit, dhe gjyqtarja i bënë presion Prokurorisë që të rikualifikoj veprën penale dhe e njëjta e rikualifiikon në dëm të mbrojturit tim. Ndërsa ka shtuar se kohë të kryerjes së veprës penale e merr kohën e arrestimit, dhe propozon që kjo ankesë të aprovohet si e bazuar si dhe propozon që të ndërrohet kryetarja e kolegjit, ndërsa i akuzuari B.V deklaron se i përkrahë në tërësi thëniet e mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit XH.A, av.Naim Rudari në deklarimin e tij thekson se mbetem në tërësi pranë ankesës me shkrim dhe shtonë se Gjykata e Apelit me të drejtë ka anuluar dhe ka kërkuar të vërtetohet se kush është vë në lajthim, por gjykata e shkallës së parë nuk i ka evituar të njëjtat, si dhe thirret se kemi parashkrim absolut, e që gjykata duhet ta anuloj aktgjykimin e atakuar dhe XH.An ta liroj nga akuza, sepse nuk kemi të bëjmë me përgjegjësi penale, pra të aprovohet ankesa dhe aktgjykimi të anulohet, ndërsa i akuzuari XH.A deklaron se i përkrahë në tërësi thëniet e mbrojtësit të tij. Kurse mbrojtësi i të akuzuarit V.O, av.Ramiz Krasniqi në deklarimin e tij thekson se mbetem në tërësi pranë ankesës me shkrim dhe propozon që e njëjta të aprovohet në tërësi.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara

Pretendimet ankimore të mbrojtësve

Në ankesë e njëjtë të akuzuarës E.B dhe mbrojtësit të saj av.Liridon Tafa, theksohet se në aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje procedurale sepse mungon arsyetimi mbi faktet vendimtare të cilat i përbëjnë elementet e figurës së veprës penale, pra për veprat penale në të dy dispozitivat e aktgjyimit dhe se gjykata në arsyetimin e saj lidhur me veprën penale të mashtrimit vetëm e ka hequr krimin e organizuar nga aktgjykimi paraprak, duke e marrë kështu vendim në kundërshtim me nenin 384 par.1 nën par.1.10 të KPPRK.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, thekson se Gjykata Themelore duke u bazuar në sugjerimet e Gjykatës së Apelit ka kërkuar përgjigje nga Drejtoria për Urbanizëm dhe nga U... R...i Prishtinës, ku me dt.01.08.2023 Drejtoria për Urbanizëm i është përgjigjur gjykatës lidhur me këtë çështje dhe janë lëshuar kushtet urbanistike në emër të pronarëve dhe investitorit E.B, si dhe U... R...i Prishtinës ku tregon se pronarët e tokave kanë aplikuar për kushte teknike dhe me dt.07.04.2010 është lëshuar dokumenti për kushte teknike të pjesshme dhe është konstatu se mund të ndërtohen vetëm dy objekte, kurse dy objekte të tjera jo, me arsyetimin se gypi i cili ka qenë nuk lejon që të ndërtohen edhe dy të tjera.

Tutje e njëjta ka shtuar se gjykata, duke mos konsideruar fare lejen urbanistike e cila nuk lëshohet pa kushtet teknike, ku në planin për ndërtim ishin paraparë të ndërtoheshin katër objekte, për të cilat edhe merret kjo leje dhe fillohet ndërtimi, gjatë punimeve haset në gypin për të cilin U... R...i Prishtinës njofton në vitin 2010 ku pronaret e tokave pas shpërfaqjes se problemit duke e anashkaluar investitorin këtu të pandehurën bëjnë kërkesë në ujësjellës për këtë gyp, ndërsa gjykata vetëm konstaton se E.B ka qenë e njoftuar lidhur me gypin, pra provat e kërkuara nga këto dy institucione vetëm sa e shfajësojnë E.B, e jo fajësojnë për veprën penale të mashtrimit, e si rrjedhojë dhe veprën penale të shpërlarjes së parave.

Lidhur me shkeljen e ligjit penal konsideron se ka pasur shkelje të ligjit penal sa i përket kualifikimit juridik të veprës penale, se e njëjta akuzohet mbi bazën e supozimit të pa provuar dhe mbi bazën e paragjykitimit, duke mos i konsideruar edhe faktet tjera supozon dhe ia vë në barrë të gjitha veprat për të cilat akuzohet dhe veprime me qëllim të mashtrimit konsiderohet ndryshimi i emrit nga “ERA” si biznes individual në “Venus O Gr” SH.P.K. Ndërsa sa i përket veprës penale shpërlarja e parave, konsideroj se për këtë vepër penale me asnjë provë prokuroria nuk e provon se pasuria në fjalë të këtë buruar nga ndonjë aktivitet kriminal, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit V.B, av.Murat Demolli, thekson se dispozitivi i aktgjykitimit të ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPP-së, sepse i njëjti është i pa kuptueshëm dhe kundërthënës në brendinë e tij, dhe se arsyetimi i të njëjtit në raport me të mbrojturin tim është në kundërshtim me vetvete. Në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, pra të njëjtat janë plotësisht të pa qarta dhe kundërthënëse dhe të një anshme, si dhe nuk ka përcaktuar se cilat prova i ka konsideruar të vërtetuara dhe të pavërtetuara, e që vetë kontradikta

e dispozitivit të aktgjykimit në vetvete dhe me arsyetimin e bëjnë jo kompatibil si më lartë. Sipas mbrojtjes, në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar nuk ka përshkrim të fakteve dhe rrethanave që përbëjnë figurën e veprës penale të mashtrimit për të cilën është shpallur fajtor i mbrojturi im. Sipas mbrojtjes shkelje tjetër esenciale e dispozitave të procedurës penale, konsistojnë në atë se gjykata e shkallës së parë jo vetëm duke e mbështetur aktakuzën pa u lëshuar fare në verifikimin e saj dhe shkresave tjera, por edhe e ndryshon dhe e plotëson akuzën, duke e bërë kështu dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar në kundërshtim me arsyetimin dhe provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, thekson se nëse analizohen provat e administruara shihet se gjykata ka marrë si të vërtetuar pretendimet e prokurorisë të veprës penale mashtrimi duke mos vlerësuar drejtë një mori elementesh faktike, e ato të cilat janë vlerësuar në bazë të kriterëve të njëanshme që gjykata e shkallës së parë i ka aplikuar me rastin e vlerësimit, të njëjtat janë të paqëndrueshme sepse është bërë vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, në dëm të mbrojturit tim.

Nuk është kontestuese fakti se i mbrojturi im ka qenë në marrëdhënie pune në kompaninë V.....- o – G.... në cilësinë e zyrtarit të lartë për marketing, i cili ka pasur urdhër që palët e interesuara të i dërgoj dhe të shohin për së afërmi vendin dhe objektin ndërtimor, por sipas mbrojtjes si mund të cilësohet për veprë penale kur punëtori i cili është në marrëdhënie pune ju tregon palëve të interesuara vendin ku është duke u ndërtuar objekti banesor. Gjithashtu mbrojtja shtonë se asnjëri nga të dëmtuarit apo bashkë akuzuarit të cilët janë marrë në pyetje, asnjëherë asnjëri i dëmtuar nuk u deklarua për ndonjë mashtrim apo marrje të mjeteve financiare nga i mbrojturi im dhe asnjëri nga ta nuk ka deklaruar se i mbrojturi im ka nënshkruar ndonjë para kontratë, sepse i njëjti nuk ka pasur qasje në asnjë rast të nënshkrimit të tyre, e as në llogarinë bankare të biznesit nuk ka bërë transaksione apo tërheqje të mjeteve financiare.

Lidhur me shkeljet e ligjit penal, mbrojtja thekson se është shkelur ligji penal në dëmin e të akuzuarit V.B, pasi që aktgjykimi ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të cilat kanë pasur për pasojë shkeljen e ligjit penal në dëm të mbrojturit tim, pasi që me vetë ngritjen e aktakuzës dhe nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar është shkelur në mënyrë flagrante ligji penal, sepse është akuzuar për veprën penale të cilën nuk e ka kryer, e po ashtu është aplikuar gabimisht dispozita ligjore e nenit 24 të KPK-së, pasi që i njëjti nuk e ka kryer veprën penale të mashtrimit siç pretendon prokuroria

dhe gjykata, prokuroria speciale ka ngritur aktakuzën për veprën penale krim i organizuar nga neni 274 par.1 lidhur me par.2 e në raport me E.B par.3 të KPK-së (i vjetër) lidhur me veprën penale mashtrimi nga neni 261 par.1 lidhur me par.2 të KPK-së (i vjetri), ndërsa gjykata ka marrë për bazë kodin e ri penal i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2013.

Lidhur me vendimin mi dënimin mbrojtja thekson se edhe në këtë pikëpamje aktgjykimi është i kundërligjshëm, pasi që Gjkata e shkallës së parë, është dashur ta ketë parasysh si rrethanë të pakontestueshme se i mbrojturi im me rastin e lidhjes së kontratës së punës ka pasur edhe përgjegjësi për kryerjen e punës dhe nga të gjitha provat e dorëzuara nga prokuroria, asnjë provë nuk e vërteton se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, pra mbrojtja konsideron se këto rrethana është dashur që ti analizoj dhe vlerësoj drejtë dhe i mbrojturi im në këtë çështje të këtë statusin e viktimës e jo të akuzuarit, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit B.V, av.Fanol Krasniqi, thekson se aktgjykimi i atakuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.9, 1.10 dhe par.2 nënpar.2.1, 2.4, 2.6 dhe 2.7 të KPP-së, sepse i njëjti është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, si dhe ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e tij lidhur me përmbajtjen e shkresave të lëndës. Tutje shton se aktgjykimi nuk është përpiluar konform dispozitave të nenit 369 të KPK-së dhe i njëjti mbështet në prova të papranueshme, po ashtu dispozitivet e aktgjykimit janë të pa qartë, për faktin se në bazë të nenit 369 (4) të KPP-së kur i akuzuari shpallet fajtor në të duhet të përfshihen të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara sipas nenit 364 par.1 nënpar.1 të KPP-së duke përfshirë vetëm faktet vendimtare dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale. Ndërsa në rastin konkret dispozitivi i aktgjykimit në raport me të akuzuarin është i mangët (dhe i referohet këtij dispozitivi), i pa precizuar lidhur me veprimet individuale të secilit të akuzuar si dhe në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit lidhur me kohën, mënyrën dhe vendin e kryerjes së veprës penale.

Gjkata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase ka shkelur edhe nenin 384 pika 1.10 të KPPK-së dhe Kushtetutën me tejkalimin e aktakuzës, për faktin se aktakuza është ngritur me kodin e përkohshëm, kurse gjykata e ka dënuar me kodin e ri penal. Po ashtu gjykata ka vendosur në mënyrë të kundërligjshme për kompensimin e dënimit, duke vendosur në mënyrë selektive për kërkesat pasurore të cilat nuk i arsyeton fare.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, thekson se gjykata në arsyetimin e vendimit gjen kontradikta mes deklaratave të pandehurit B.V dhe të bashkëpandehurve, si dhe mes vetë deklaratave të tij, mirëpo deklaratat e B.V gjatë fazave të ndryshme nuk kanë asnjë kontradiktë, sepse i njëjti nuk ka mohuar asnjëherë që ka qenë i punësuar tek E.B, se ka pranuar dhurata për dasmë, si dhe nuk e ka mohuar që automjetin e ka poseduar në emrin e tij, e as nuk e ka mohuar se ka qenë ndërmjetësues në mes pronarëve të tokave dhe E.B, si dhe me iniciativën e tij vëllai i tij është bërë blerës, dhe se gjatë vitit 2012 E.B i ka mbetur borxh në paga.

Mbrojtja po ashtu shtonë se gjatë vlerësimit të provave personale gjykata fare nuk përfshinë deklaratën e Safet Sahitit si dhe thëniet e tij, dhe me as një provë gjykata nuk i mbështet konstatimet lidhur me bashkëkryerjen dhe veprimet individuale të pandehurve e cila paraqet konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Provat në të cilat mbështetet aktgjykimi janë në kundërshtim me përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit, ku gjykata ka marrë si kohë të kryerjes së veprës penale ditën e arrestimit të akuzuarve, ku po ashtu konstatimet si në arsyetimin e aktvendimit të atakuar bien në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit L.G, përveç kësaj nuk ka kontratë në të cilën ka nënshkruar ose ka qenë B.V, sepse ai nuk ka pasur rol dhe as pozitë që të njëjtin do ta bënte faktor.

Po ashtu gjykata gjithashtu nuk ka vlerësuar gjendjen faktike lidhur me pengesat gjatë punimeve, sidomos të pranisë së gypit të ujësjellësit, e po ashtu nuk është vlerësuar fare gjendja faktike lidhur me shpenzimet e ndërtimit, e materialit ndërtimor, administrative apo të vetë kompanisë. Lidhur me shkeljet e ligjit penal, thekson është shkelur ligji penal në dëmin e të akuzuarit B.V, pasi që vepra me të cilën i akuzuari ndiqet nuk është vepër penale, ngase ndërmjetësimi, shitja ose vozitja e klientëve të një biznesi prej zyrës se biznesit e deri të vend punishte nuk është vepër penale, nuk ka elemente të veprës penale pasi që këto veprime i legalizon LMD-ja, dhe në këtë rast nëse nuk do të ishte tejkualuar akuza me rikualifikimin e veprës penale, tanimë do të arrinte parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Kjo mbështetur në faktin se të gjitha provat personale dhe materiale objekt vlerësimi dhe shqyrtimi kanë pasur kohën e kryerjes së veprës penale nga viti 2009 deri 2011, ku nuk mund të thuhet se kohë e kryerjes së veprës penale është dita e arrestimit të akuzuarit dhe se ndaj të njëjtit është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet duke e bërë rikualifikim në dëm të akuzuarit, duke shkelur kështu edhe Kushtetutën dhe të drejtat e garantuara e ligj. Mbrojtja po ashtu të shkeljet e ligjit penal ju referohet edhe dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve lidhur me kontratat, duke shtuar kështu se pasi që aktgjykimi

është përfshirë me një numër të madh shkeljes, nuk ka mundësi as norma materiale të jetë zbatuar drejtë. Gjithashtu aktgjykim i ankimuar është jo ligjor edhe nga aspekti i vendimit mbi dënimin, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit XH.A, av.Naim Rudari, fillimisht ka përshkruar kronologjinë e rrjedhës së gjyqimit dhe se lidhur me këtë çështje është tejkualuar kompetenca ekskluzive e Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti Special, ndërsa këtë çështje e ka trajtuar gjykata e cila nuk ka pasur kompetence fare (për arsye se në këtë çështje ka pasur gjyqtar dhe prokuror kinse janë dëmtuar por janë kompensuar me parë dhe se nuk kanë qenë palë në procedurë), ndërsa në raport me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, thekson se gjykata e shkallës së parë në raport me të mbrojturin tim prapë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale duke vepruar në kundërshtim me nenin 384 të KPPRK-së, konkretisht në shpërputhje me paragrafët 1.3 shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, 1.7. aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes, 1.10 aktgjyqimit i mungon plotësisht arsyetimi, 1.8 aktgjykimi bazohet në prova të pa pranueshme, po ashtu në shpërputhje edhe me nenin 384 par.2 nënpar.2.1, 2.5, 2.6, 2.7 si dhe aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 par.4 dhe 6 ku parashihet se gjykata në arsyetim paraqet arsye për çdo pik të aktgjyqimit.

Sipas mbrojtjes me aktgjykim e ankimuar nuk janë evituar shkeljet e bëra më parë, sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, por e njëjta padrejtësisht konstaton kinse është kryer vepra penale mashtrimi nga neni 355 par.5 të KPRK, duke përjashtuar kështu ligjin që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, si ligj më të favorshëm dhe se gjykata gjykon për një vepër që tani më është e parashkruar. Sipas mbrojtjes në shqyrtimet gjyqësore nuk janë ftuar të dëmtuarit, pra nuk janë ftuar të gjithë të dëmtuarit si palë në procedurë, dhe disa nga ta nuk janë ftuar asnjëherë për të dëshmuar, por janë bazuar në deklaratat e tyre të mëhershme, përveç kësaj gjykata ka lejuar të dëmtuarit të cilët kanë qenë prezentë, që të përfaqësojnë njëri tjetrin, pra ata të cilët kanë munguar, e po ashtu ka lejuar që të njëjtit të përfaqësohen edhe nga familjarët e tyre, ku një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 64 të KPP-së, e cila dispozitë përcakton se kush duhet ta përfaqësoj të dëmtuarin.

Tutje mbrojtja ka shtuar se aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes të cekur në hyrje të ankesës, kurse aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme, pra kryesisht bazohet në thashetheme e në supozime dhe se gjykata

padrejtësisht pretendon se XH.A së bashku me E.B kanë fshehur objektin A1 që ishte në ndërtim e sipër, duke e anashkaluar faktin që ka deklaruar vetë E.B se ajo ka marrë në formë huajve 400.000 euro nga XH.A dhe më pas 50.000 euro ia kishte kthyer, ndërsa 350.000 euro i kishte mbet borxh. Po ashtu ka anashkaluar deklaramet e pronarëve të tokave të cilët kanë deklaruar se XH.A i kishte lutur që ata të vazhdonin kontratën me E.B dhe të përfundonin projektin. Pra aktakuza e cila ishte objekti shqyrtimi në këtë procedurë gjyqësore nuk përmbante dyshimin e bazuar mirë që nga fillimi i saj, e as nuk u krijua për asnjë moment, e cila do të duhej të vërtetohej përtej dyshimit të bazuar mirë në shqyrtim gjyqësor.

Sipas mbrojtjes aktgjykimi nuk përmban argumente të vërtetuara dhe se në shqyrtim gjyqësor nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare në të cilat është mbështetur aktgjykimi, dhe krahas me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i mbrojturi im, të njëjtit aktgjykim nuk i janë bashkangjitur faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale.

Pra gjykata arsyetimin e ka mbështet në provat materiale duke mos dhënë arsye se në cilat prova i mbështet faktet e marrëveshjes paraprake si formë e bashkëpunimit, sepse në mungesë të arsyeve për këto fakte aktgjykimi është i pa qëndrueshëm dhe i përfshirë në shkelje esenciale, pasi që XH.A ka realizuar kompensimin e tij i njëjti është akuzuar se ai ka kryer veprën penale shpërlarja e parave, kinse i njëjti ka fshehur gjurmët e pasurisë që ka buruar nga aktiviteti kriminal. Edhe përkundër asaj që prokuroria nuk ka afruar asnjë provë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë se XH.A, ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, as në shqyrtim gjyqësor nuk u shpalos asnjë provë që dëshmon se ai ka kryer një vepër të tillë, po ashtu asnjëri nga dëshmitarët e dëgjuar nuk ka përmendur asnjëherë XH.A apo ndonjë veprim inkriminues që ai ka ndërmarrë. Prandaj mbrojtja konsideron se me gjykimin e kësaj lënde por edhe në shqyrtimin gjyqësor janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat shkelje janë të pa pranueshme duke e bërë kështu aktgjykimin e kundërligjshëm dhe të pa bazë.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjen faktike, thekson se gjykata ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 386 të KPPRK, ku gjykata gabimisht ka vërtetuar ndonjë fakt të rëndësishëm, pra gjykata gabimisht ka vërtetuar se XH.A i ka mundësuar të akuzuarës E.B fshehjen e gjurmëve të pasurisë, objektin të cilën e njëjta ka filluar ta ndërtoj me mjete financiare të përfituara me aktivitet kriminal, gabimisht ka vlerësuar se E.B ka përfituara pasuri nga aktiviteti kriminal, gabimisht ka vërtetuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale të mashtrimit dhe krimi i organizuar, po ashtu

gabimisht ka vërtetuar se XH.A ka bërë krim pasi që ka pranuar një autorizim të vërtetuar nga Gjykata, si dhe gabimisht ka vërtetuar se tek i akuzuari qëndron dashja dhe dijena e tij që në bashkëkryerje kanë fshehur dhe transferuar objektin A1 që ishte në ndërtim e sipër.

Gjithashtu mbrojtja shtonë se gjykata nuk ka vërtetuar faktin se E.B kishte qenë punëtoare në Reiffeisen Bank, se XH.A ia kishte dhënë borxh shumë prej 400.000€ me kusht që të kompensohet në ndërtim, nuk ka vërtetuar se E.B nuk ka qenë e vetme në ndërtim por kishte lidhur kontratë për bashkëpunim me pronarët e tokave, nuk ka vërtetuar faktin se e njëjta kishte ndërmarrë veprime konkrete në teren, e po ashtu faktin se e njëjta ka pasur vështirësi për të përfunduar atë projekt pasi që kishte pasur disa ngecje, nuk ka vërtetuar as faktin se dëshmitari D.B i cili kishte vazhduar projektin e ndërtimit së bashku me pronarët e tokave i njëjti në deklaratimet e tij ka thënë se evitimi i problemit me gypin ka zgjatur 6-7 vite, po ashtu faktin se disa nga blerësit vullnetarisht kishin prishur kontratat. Pra, sipas mbrojtjes gjykata nuk ka vërtetuar edhe shumë fakte të tjera siç janë ato se blerësit e banesave kishin lidhur para kontrata në objektin tjetër të cilin E.B kishte filluar, se e njëjta ishte rrahur e kanosur disa herë, faktin se sikur XH.A edhe 27 persona të tjerë ishin kompensuar nga E.B, po ashtu nuk ka vërtetuar gatishmërinë e dëshmitarit B.M, e gjithashtu nuk ka vërtetuar faktin se pronarët e tokave kanë thënë se XH.A i ka lutur që të vazhdojnë projektin me Estridën por ata nuk kanë dashur.

Lidhur me shkeljet e ligjit penal, mbrojtja thekson se është shkelur ligji penal në kundërshtim me dispozitën e nenit 385 të KPPRK-së, sepse vepra për të cilën akuzohet i mbrojturi im nuk është veprë penale dhe se nuk është vërtetuar se kanë ekzistuar veprimet e XH.A të cilat do të përbënin elementet e veprës penale. Tutje mbrojtja thirret në parashkrimin absolut të ndjekjes penale.

Sipas mbrojtjes shkelja e ligjit penal, po ashtu është bërë me rastin e zbatimit të ligjit penal i cili nuk duhet të zbatohet vetëm e vetëm për tu dukur ndryshe parashkrimi i cili ka kapur këtë çështje shumë kohë më parë dhe se gjykata padrejtësisht mendon se ndaj të pandehurit duhet të aplikohet edhe ligji që është i disfavorshëm, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit V.O, av.Ramiz Krasniqi, përveç tjerash thekson se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm dhe kundërthënës në brendinë e tij, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, ka kundërthënë të konsiderueshme, e po ashtu

aktgjykimi nuk është përpiluar konform dispozitave të nenit 369 të KPP-së. Sipas mbrojtjes, aktgjykimi mbështetet në prova të papranueshme, të cilat aktgjykimin e bëjnë të paligjshëm dhe se mbi faktet vendimtare ekziston një kontradiktë e konsiderueshme midis asaj çka paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit. Mbrojtja po ashtu shtonë se arsyet si në aktgjykim nuk janë bindëse dhe nuk janë mbështetur në shkresat e lëndës lidhur me elementet e veprës penale për të cilën i mbrojturi im është shpallur fajtor dhe dënuar.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale konsistojnë në atë se dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë, sepse kur i akuzuari shpallet fajtor përfshinë të gjitha të dhënat e nevojshme sipas nenit 364 par.1 nën par.1 të KPPRK dhe në rastin konkret dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë, konfuz dhe i pakuptueshëm, e po ashtu përshkrimi i veprës penale nuk ka mbështetje në provat e administruara.

Me tutje mbrojtja i referohet arsyetimit të aktgjykimit me pretendimin se aktgjykimi i Gjykatës së shcallës së parë është i paarsyetuar sepse në të janë bartur procesverbalet nga seancat gjyqësore pa bërë asnjë analizë, duke mos cekur se cilave prova ju ka falur besimin dhe cilave jo. Po ashtu aktgjykimin e bënë të pa qartë fakti se gjatë vlerësimit të mbrojtjes së V.O gjykata tregon pse nuk i ka besuar mbrojtjes së tij, duke përmendur kështu mospërputhje të deklaratave të E.B dhe V.O, e të cilat mospërputhje sipas mbrojtjes janë aq të parëndësishme sa nuk ja vlen të përmenden. Ka shtuar se në pjesën e fundit të aktgjykimit thuhet se E.B i ka blerë një truall në fshatin Ll.... në sipërfaqe prej 5 ari, kurse në arsyetimin e aktgjykimit thuhet se ky truall i blerë prej 5 ari nuk qenka blerë nga N.K por nga B.G, pra ky ngatërrim i kësaj ngastre ka ardhur nga pakujdesia e hartuesit të aktgjykimit, fakte këto të cilat e bëjnë të paqëndrueshëm aktgjykimin.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, thekson se nuk dihet se cila është gjendja faktike dhe se nuk mjafton vetëm të thuhet se nga administrimi i provave u vërtetua gjendja faktike sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi, pra mbrojtja konsideron se nuk mund të vërtetohet gjendja faktike vetëm me numërimin e provave materiale që janë administruar dhe me bartjen e deklaratave të dëshmitarëve – të dëmtuarve nga procesverbalet e seancave, pa bërë një analizë dhe pa theksuar se a ju beson gjykata këtyre deklarimeve apo jo, e kjo për faktin se këto prova vetëm janë marrë nga aktakuza dhe janë konsideruar si të administruara në aktgjykim. Mbrojtja po ashtu shtonë se në aktgjykim nuk thuhet se si ishte e mundur të bëhet pastrimi i parave nëse E.B gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011 V.O i ka dërguar para përmes Wester Unionit

shumën prej 16.000 euro, e të cilin fakt nuk e konteston as E.B dhe as V.O, mirëpo është kontestuese se cili do të ishte argumenti juridik se V.O e ka ditur se E.B po u marrka me aktivitete kriminale dhe se këto para ja ka dërguar me qëllim që të njëjtat ti fshehë apo maskoj. Pra sipas mbrojtjes nga provat e administruara nuk del kjo që e thotë aktgjykimi, ku dhe kemi një provë të administruar nga e cila thuhet se transaksioni është bërë në mes të E.B dhe V.O përmes Wester Unionit sikurse në faqen 132 të aktgjykimit të atakuar.

Me tej mbrojtja shton se asnjë provë e vetme nuk është administruar në gjykatë që e vërteton këtë që e thotë aktakuza e pastaj edhe aktgjykimi i atakuar, pra në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë se E.B ka lidhje me këtë troll, se e njëjta këtë troll ja ka blerë V.O, pasi që e njëjta edhe ka deklaruar se “as nuk i kam blerë trollë V.O, e as nuk e di dhe as që kam qenë ndonjë herë në këtë troll”, dhe se gjykata e ngatërron parcelën e blerë nga V.O në fsh.Ll.... me parcelën në lagjen Qëndresa, e të cilat lagje kanë një distancë së paku 15 kilometra. Trolli në sipërfaqe prej 0,5.21 ari që gjendet në fshatin Ll.... është blerë nga N.K dhe se kontrata në mes të shitësit N.K dhe blerësit V.O është vërtetuar në gjykatë, të cilën troll e ka blerë në vitin 2007 para se ta njoh E.B, por kontratën me shitësin e ka lidhur me vonë.

Lidhur me shkeljet e ligjit penal, mbrojtja thekson se është shkelur ligji penal në dëmin e të akuzuarit V.O, pasi që aktgjykimi ka një mori shkeljes të dispozitave të procedurës penale, kur gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, edhe shkeljet e ligjit janë të pa shmangshme dhe se në rastin konkret të i mbrojturi im asnjëra nga karakteristikat e kësaj vepre penale nuk përmbushen, e që në rast se gjykata do të merrej me konstatime të natyrës materiale, gjykim do të duhej të kishte epilog tjetër.

Lidhur me sanksionin penal thekson se vendimi mbi dënimin nuk është i ligjshëm, pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Gjykata e shkallës së parë, të njëjtin së bashku me të akuzuarit e tjerë i ka obliguar që në mënyrë solidare të paguajnë dëmshpërblimin ndaj të dëmtuarve sikurse në aktgjykimin e atakuar, por mbrojtja shtonë se pse duhet i mbrojturi im të bëjë kompensimin me të tjerët dhe si mund të ketë dëmshpërblim për të dëmtuarit nga V.O kur i njëjti akuzohet për shpërlarje parash dhe askujt nga të përmendurve nuk ju ka shkaktuar asnjë dëm, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Të gjeturat e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore të mbrojtësit nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtëseve se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 dhe 2 të KPP-së, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsytet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar konform dispozitave të nenit 369 par. 6 të KPPK-së, ku gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsytet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë. Vlerësimi i provave është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 të KPPRK-së, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendimin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga të akuzuarit, për të cilën veprë penale të akuzuarit të akuzuarit edhe janë shpallur fajtor, pra gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur përfundimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Pretendimi i mbrojtës dhe i të akuzuarës E.B, se në aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje procedurale sepse mungon arsyetimi mbi faktet vendimtare të cilat përbëjnë elementet e figurës së veprës penale, janë pretendime të pa bazuara, pasi që në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye të qarta dhe konkrete në raport me veprimet inkriminuese të secilit të akuzuar për veprat penale për të cilat janë gjendur fajtorë.

Ndërsa pretendimet e mbrojtësit V.B, av.Murat Demolli se shkeljet esenciale konsistojnë edhe në atë se gjykata e shkallës së parë jo vetëm duke e mbështetur aktakuzën pa u lëshuar fare në verifikimin e saj dhe shkresave tjera, e ndryshon dhe e plotëson akuzën, duke e bërë kështu dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar në kundërshtim me arsyetimin dhe provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Gjithashtu janë pretendime të pa bazuar pasi që në pikën e I-

rë të dispozitivit sipas Aktakuzës PPS nr. 04/2015 të datës 12 maj 2016, të akuzuarit E.B, V.B dhe B.V, janë akuzuar se kanë kryer veprën penale Krim i orG.Hzuar nga neni 274 par. 1 lidhur me par.2 e në raport me E.B par.3 të KPK-së (i vjetri), lidhur me veprën penale mashtrimi nga neni 261 par.1 lidhur me par.2 të KPK-së (i vjetri), megjithatë nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve E.B, V.B dhe B.V, janë manifestuar elementet e veprës penale Mashtrim nga neni 335 par.5 me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, duke përjashtuar kështu krim e orG.Hzuar.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit B.V, av.Fanol Krasniqi se gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase ka shkelur edhe nenin 384 pika 1.10 të KPPK-së dhe Kushtetutën me tejkalimin e aktakuzës, për faktin se aktakuza është ngritur me kodin e përkohshëm, kurse gjykata e ka dënuar me kodin e ri penal. Po ashtu gjykata ka vendosur në mënyrë të kundërligjshme për kompensimin e dënimit, duke vendosur në mënyrë selektive për kërkesat pasurore të cilat nuk i arsyeton.

Sipas Kolegjit, theksimet e tilla nuk qëndrojnë për arsye se është fakt se aktakuza është ngritur me kodin penal, që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes se veprës penale, megjithatë të akuzuarit janë shpallur fajtor për veprën penale mashtrimi të kryer në vazhdim, pasi që veprimet inkriminuese të akuzuarve përfshinë edhe periudhën kohore pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal të publikuar në gazetën zyrtare Nr.19/13 korrik 2012, i cili ka hyrë fuqi nga 1 janar 2013, pasi që të njëjtit kanë vazhduar ti mbajnë në lajthim të dëmtuarit për ndërtimin e banesave. Lidhur me këtë ekzistojnë parakontrata edhe gjatë viti vitit 2013 për mes të cilave të dëmtuarit janë mbajtur në lajthim, siç është rasti i S.F.B, me të cilën e akuzuara E.B ka lidhur para kontrate mbi shitblerjen e paluajtshmërisë së banesës, e cila është lidhur me datë 15.03.2013. Gjithashtu ekziston marrëveshja e datës 25. 01. 2013, e lidhur me S.M, për pagimin e qerasë. Për rrjedhojë në situatat e tilla ka vazhduar aktiviteti inkriminues dhe ngjarja kriminale ka pasur kontinuitet, prandaj si e tillë duhet të trajtohet si një tërësi, dhe veprimet inkriminuese janë ndërmarrë gjatë vitit 2013, në këto situata duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një vepër penale, zbatohet ligji i cili ka qenë në fuqi në momentin e ndërmarrjes së veprimit të fundit, pavarësisht që shumica e veprimeve janë kryer në kohën kur ka qenë kodi i përkohshëm penal i aprovuar me 6 korrik 2003 dhe në fuqi prej 6 prill 2004.

Kolegji rikujton se vepra penale mashtrimi nga 335 par. 5 të KPRK-së, është e dënueshme prej tre (3) deri në dhjetë (10) burgim. Ndërsa në kuptim të nenit 106 par.3 të KPRK-së parashkrimi i ndjekjes penale përcakton periudhën kohore prej dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të

dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim, ndërsa dyfishi i kohës së parashkrimit të ndjekjes penale në kuptim të nenit 107 par.8 të KPRK-së është 20 vite, prandaj nuk është arritur afati i parashkrimit.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit Xh.A, av.Naim Rudari, se lidhur me këtë çështje është tejkalluar kompetenca ekskluzive e Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti Special, ndërsa këtë çështje e ka trajtuar gjykata e cila nuk ka pasur kompetence fare (për arsye se në këtë çështje ka pasur gjyqtar dhe prokuror kinse janë dëmtuar por janë kompensuar me parë dhe se nuk kanë qenë palë në procedurë), ndërsa në raport me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, thekson se është vepruar në kundërshtim me nenin 384 par.1 dhe 2 të KPP-së të cekura specifiskisht si në ankese.

Janë pretendime të pa bazuara, fillimisht përkitazi me kompetencën janë dhënë arsye të cilat i ka cekur edhe vetë mbrojtësi në ankese se në këtë çështje penal si palë të dëmtuar kanë qenë gjyqtar dhe prokuror, andaj me qëllim të mos vënies në pikëpyetje të objektivitetit të Gjykatës Themelore në Prishtinë me rastin e vendosjes më këtë lëndë e njëjta është bartur për trajtim të mëtejme në Gjykatën Themelore në Pejë.

Pretendimi se nuk janë evituar shkeljet e bëra më parë, sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, por e njëjta padrejtësisht konstaton kinse është kryer vepra penale mashtrimi nga neni 355 par.5 të KPRK, duke përjashtuar kështu ligjin që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, si ligj më të favorshëm dhe se gjykata gjykon për një vepër që tani më është e parashkruar.

Janë pretendime të pa bazuara, pasi që nga provuarit e fakteve rezulton se të akuzuari në pikën I të dispozitivit e kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 355 par.5 të KPRK-së, duke përjashtuar kështu krimin e organizuar të inkorporuar me veprën penale mashtrimi siç fillimisht ishin akuzuar, gjithashtu në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim ngase ekzistojnë parakontrata edhe pas vitit 2013, dhe se të dëmtuarit gjatë gjithë kohës janë mbajtur në lajthim. Pretendimi se në shqyrtimin gjyqësor nuk janë ftuar të gjithë të dëmtuarit si palë në procedurë, dhe disa nga ta nuk janë ftuar asnjëherë për të dëshmuar, por janë bazuar në deklaratat e tyre të mëhershme, përveç kësaj gjykata ka lejuar të dëmtuarit të cilët kanë qenë prezentë, që të përfaqësojnë njëri tjetrin, pra ata të cilët kanë munguar, e po ashtu ka lejuar që të njëjtit të përfaqësohen edhe nga familjarët e tyre, ku një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 64 të KPP-së, e cila dispozitë përcakton se kush duhet ta përfaqësoj të dëmtuarin.

Kërkesat tilla janë të paqëndrueshme, pasi që nga gjykata e shkallës së parë janë bërë përpjekje për sigurimin e të gjithë të dëmtuarve, mirëpo për shkak të periudhës së gjatë kohore ka qenë e pa mundur të sigurohen të gjithë të dëmtuarit, megjithatë ekzistojnë deklaratat e tyre në fazat tjera të procedurës që janë pjesë e shkresave të lëndës, si dhe ekzistojnë prova që janë lidhur kontrata e para kontrata, ndërsa sa i përket pretendimit që për të njëjtit është lejuar të përfaqësohen edhe nga familjarët e tyre, kjo rrethanë është e evidente vetëm përkitazi me kërkesën për dëmshpërblim, ku i dëmtuari Q.B ka paraqitur kërkesës për dëmshpërblim në shumën prej 13.000 euro, ndërsa gjykatës i ka dorëzuar edhe dokumentacionin edhe për vëllain e tij J.B të cilat i kishte dërguar i njëjti edhe më parë në prokurori speciale në shumën prej 11.000 euro, si dhe i dëmtuarit F.B dhe në emër të T.P.B ka paraqitur kërkesën për dëmshpërblim në shumën prej 17.500 euro.

Pretendimi se aktgjykimi është i pa qëndrueshëm dhe i përfshirë në shkelje esenciale, pasi që XH.A ka realizuar kompensimin e tij i njëjti është akuzuar se ai ka kryer veprën penale shpërlarja e parave, është i pa bazuar. Kolegji ndan pikëpamjen e njëjtë me trupin gjykues të gjykatës së shkallës së parë, nga provat e procedura është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Nga deklaratat mbi participimin e ndërtimit të objektit afarist E.B dhe XH.A dt.08.09.2009, rezulton se E.B dhe Xh.A kishin shënuar se E.B pranon nga XH.A shumën prej 350.000 euro, të cilat do të shfrytëzoi për fillimin e ndërtimit të objekteve banesore dhe që me dt.30.10.2009, pranon që në emër të mjeteve financiar ti kompensoi hapësirën banesore neto 1000 metra katror. Hapësira do të jetë në objektin A1, A2, A3 dhe A4 në secilin nga 250 metra katrore. Këtë deklaratë gjykata e vlerësoi si jo të besueshme nga se nuk kishte kontratë dhe nuk kishte dëshmi për dhënien e të hollave e që të dy të akzuarit lidhur me këto të holla kishin dhënë deklaratat që binin në kundërshtim me njëri tjetrin dhe vet deklaratat e tyre, për më tepër një transaksion i tillë nuk ishte legalizuar në gjykatë dhe i mungon forma kontraktuese nuk dihen rrethanat kur dhe si është përpiluar.

Pretendimet e mbrojtësit të akzuarit V.O, av.Ramiz Krasniqi se në pjesën e fundit të aktgjykimit thuhet se E.B i ka blerë një trollë në fshatin Ll.... në sipërfaqe prej 5 ari, kurse në arsyetimin e aktgjykimit thuhet se ky truall i blerë prej 5 ari nuk qenka blerë nga N.K por nga B.G, pra ky ngatërrim i kësaj ngastre ka ardhur nga pakujdesia e hartuesit të aktgjykimit, fakte këto të cilat e bëjnë të paqëndrueshëm aktgjykimin. Sipas vlerësimit të Kolegjit, duke marrë për bazë faktin se kjo lëndë është voluminoze lëshimet e tilla mund të jenë evidente të cilat kanë mundur të rezultojë me gabim teknik, megjithatë lidhur me këtë ekziston kontrata e shitblerjes, e vërtetuar

në Gjykatë, ku shitësi është N.K e blerësi është V.O, për të cilin për kundër faktit se i akuzuari V..., ka cekur se këtë truall e ka blerë gjatë vitit 2007, (atëherë kur fare nuk janë njohur me E...), është vërtetuar se kontrata është vërtetuar në gjykatë gjatë vitit 2010.

Të gjeturat lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Sa i përket ankesave në raport me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton që gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për faktin se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit E.B,V.B dhe B.V për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 dhe par.1 dhe lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, si dhe të akuzuarit E.B, XH.A, dhe V.O për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga neni 32 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit në bashkëkryerje lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, janë kryes të veprës penale për të cilët janë shpallur fajtor.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit në mënyrën e përshkruar si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, i kanë kryer veprat penale për të cilën janë shpallur fajtor nga fakti se të akuzuarit E.B, V.B dhe B.V sipas pikës se I të dispozitivit me datë 02 shtator 2009 me zyre në tri lokacione të ndryshme në Prishtinë e gjer me 15 maj 2014 kur dhe janë arrestuar (përveç B.V) pasi që e pandehura E.B e ka regjistruar kompaninë e biznesit NSHN “ERA” (me 29 korrik 2009) me seli në Prishtinë përmes të cilës kompani në një rast dhe me 14 tetor 2009 ka regjistruar kompaninë e biznesit “.....” Sh.P.K me nr. biznesit 70613395 dhe me numër fiskal 600363949 rr. Rexhep Luci “, 1/1 Prishtinë, me veprimtari primare ndërtim i lartë dhe i ulët. Të cilat janë udhëhequr dhe kontrolluar nga e pandehura E.B duke vepruar në cilësinë e pronares, se bashku me të pandehurin V.B në cilësinë e zyrtarit të lartë marketing dhe B.V në cilësinë zyrtarit të lartë të shitjes në kompaninë “.....” me qëllim që të sjellin dobi pasurore të kundërligjshëm për vete, me paraqitje të rreme dhe duke i fshehur faktet, i kanë shtytë personat tjerë- 176 të dëmtuar që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre, dhe atë duke i sjelle në lajthim të dëmtuarit me paraqitje të ofertave të volitshme për shitjen e banesave. Fillimisht të dëmtuarve e pandehura E.B ju ka ofruar nënshkrimin e parakontratave me të gjitha të drejtat dhe obligimet me premtimin e ndërtimit dhe dorëzimin e banesave, në afatin e paraparë me parakontrate që ishte 12-18 muaj nga lidhja e parakontratës, përkundër vlerës se paguar në çmimin shumë të ulët dhe kushteve shumë të volitshme për pagese. Paraprakisht të dëmtuarit kanë qenë të obliguar të paguanjën mjete financiare prej 5.000,00 euro vlera me e vogël e në lartësi të ndryshme dhe pastaj dy të pandehurit tjerë V.B dhe B.V në bashkëpunim me të akuzuarën E.B edhe pse kishin njohuri se banesat nuk do të ndërtoheshin dhe nuk po ndërtoheshin i shoqërojnë të dëmtuarit duke i dërguar për tua treguar vendin ku kinse do të ndërtohej apo edhe duke i shoqëruar qoftë kur është bërë pagesa në bankë. Të dëmtuarit të hollat i kanë paguar në xhirrollogari të Kompanisë “Venis-O-Group” dhe ne disa raste edhe xhirrollogarin personale të pandehurës E.B, e që të gjitha të hollat tërhiqen brenda ditës. Ndërtimit nuk është bërë

dhe të dëmtuarit nuk kanë marrë banesat e parapara në parakontratë dhe as nuk u janë kthyer të hollat (me përjashtim të disa të dëmtuarve). Ashtu që të njëjtit kanë përfituar mjete financiare në mënyrë te kundërligjshme në vlerë prej rreth 1.872,719 euro.

Nga të dëmtuarit që kanë paguar për blerje të banesave janë: A.D, A.S, A.I dhe V.I, A.V, A.G, A.M me S.M, A.B me M.B, A.G, A.H, A.M, A.H, A.B, A.K, A.K me V.M.K, A.A, A.Ç dhe A.Ç, A.S, A.J, A.K, A.M.K, A.J, A.Q, A.M, A.S, B.S, B.G, B.P, B.S, B.H, B.Sh, B.H dhe R.H, B.K, B.M dhe F.K.M, B.P, B.B, D.B, D.L, D.O, A.B dhe D.B, E.V, E.U, E.R, E.P, E.K, E.Xh dhe N.Xh, E.Gj, E.S, F.K dhe I.K, F.Sh, F.Sh, F.Z, F.B dhe S.B, F.G, F.D, F.H, F.H, F.Zh, F.E, F.E, F.H, G.H dhe V.H, G.M, G.N dhe M.N, G.H, H.K, H.K, H.L, H.D, H.Th, I.K dhe E.B, I.G dhe L.K.G, I.S, I.H, I.B dhe L.A, I.H, I.R, J.D dhe D.D, J.P, L.P, L.D, L.P dhe A.P, L.B, L.A dhe A.A, L.E, L.Sh, L.M, M.M, M.K, M.S, M.S.E, M.C, M.S.E dhe L.E, M.U, M.G, M.H, M.K dhe I.N, M.B, M.S, M.B, N.LI, N.M, N.S, N.P, N.P, N.B, N.P, N.LI, P.L, Q.K, Q.B, J.B dhe R.B, Q.R,R.K,R.S, R.M,N.D,R.Z,Rr.B, S.M,S.Sh,S.Z,S.B,S.H, S.S,S.Sh,S.M,S.K, S.M,Sh,S,Sh.K, Sh.K,Sh.G,Sh.Sh., Sh.P.H,SH.A,SH.K, S.B,S.Xh,S.S, S.F me E.F,T.P, T dhe Xh.B,V.D,V.S, V.L,V.B,V.M, Xh.S,Xh.K,Xh.B, Xh.Xh,Z.J,Z.P,Z.H. Me këtë kanë kryer vepër penale “mashtrimi” nga neni 335 par. 5 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-se.

Ndërsa sipas pikës II të dispozitivit të akuzuarit E.B, XH.A, dhe V.O në kohën, vendin dhe mënyrën të përshkruar si në piken II të dispozitivit të aktgjykimit, pasi që kanë përfituar mjete financiare në vlerë rreth 1.872,719 euro, e duke ditur se mjetet financiare të cilat kanë buruar nga aktiviteti kriminal i të pandehurve si nen piken I të dispozitivit duke tentuar ti konvertinin, transferonin me qellim të fshehjes apo maskimit të natyrës, B.Vit vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë se pasurisë. Në bashkëkryerje kanë bërë shpëlarjen e parave, ashtu që i pandehuri Xh.A; fillimisht me datën : 03 qershor 2011 ka vepruar në atë mënyrë që duke i mundësuar të pandehurës E.B si pronare e firmës, fshehjen e gjurmëve të pasurisë -Objektit që kishte filluar ta ndërtoj me mjete financiar të përfituara me aktivitet kriminal-mashtrimi, i njëjti nga e pandehura E.B ka pranuar autorizimin i vërtetuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega Graqanicë i datës 01.08.2011, me të cilin e autorizon të pandehurin XH.A që në mënyrë gjenerale dhe pa kufizime të përfaqësoj në emër personal dhe në emër të firmës “ Venis – O – Group “ me pronaret e tokave sipas kontratave për patundshmëritë lidhur me ndërtimin e banesave. Pasi që E.B ka pas obligim ndaj pronareve të truallit. Pastaj i pandehuri XH.A me datën 01.Gusht 2011, nga e pandehura E.B pranon një deklaratë të vërtetuar në Gjykatën Komunale Prishtinë-Dega Graqanicë, me të cilën vërteton se heq dore nga implementimi i kontratës për ndërtimin e banesave dhe lokaleve afaristë të legalizuara pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë Vr.nr., Vr. Nr., dt. 07.05.2009, Vr., dt.27.05.2009, dorëheqjen e benë në favor të pandehurit XH.A, ndërsa obligimet ndaj blerësve të banesave dhe pune kryesve mbesin obligim i të pandehurës E.B, dhe në fund që të humbet gjurmët edhe me shumë i pandehuri XH.A me datë 16 janar 2012 nënshkruan marrëveshje për Investime të përbashkëta me biznesin “ A.G Sh.A “ me pronar D.B, për ndërtimin e banesave dhe lokaleve afariste të cekura si me lartë.

I pandehuri B.V: në periudhën kohore të përshkruar si nen piken I të këtij dispozitivi duke ditur se E.B dhe vet i akuzuari B.V mjetet financiare i kanë përfituar me aktivitet e kriminal, me qellim që ato mjete financiare ti konvertoi, transferoi me qellim te fshehjes, apo maskimit të natyrës, B.Vit, vendit dispozicionit të mjeteve financiar nga e pandehuri E.B një automjet - Volvo një dhome fjetje, shpenzimet për dasme, shpenzimet për pushime verore dhe shpenzime tjera.

I pandehuri V.O: në përdhën kohore të përshkruar si nen pikën I të këtij dispozitivit duke ditur se e pandehura E.B mjetet financiare i ka përfituar me aktivitet kriminal me qëllim që ato mjete financiare ti fshehi, maskoi me qëllime të ndihmës nga e pandehura E.B me data të ndryshme gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011, përmes xhirollogarisë personale pranë Western Union në Danimarkë ka pranuar mjete financiare në vlerë prej 16.000, oo euro, pastaj me datën 04 Shtator 2010 në Danimarkë ka pranuar shumën e të hollave, në vlerë prej 14.600.oo euro nga A.B, në emër të pagese se borxhit për blerjen e një banese po ashtu nga E.B me datën 29.01.2010 kishte pranuar një veturë xhip HUNDAI i X55 në vlere prej 35.300,oo euro, si dhe i ka blere një truall në fshatin Ll... Komuna e Prishtinës V.Ot në sipërfaqe prej 5 ari (500 m²). Me këtë kanë kryer vepra penale, secili në bashkëkryerje në raport me E.B Shpërlaja e Parave nga neni 32 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes se Parave dhe Financimit të Terrorizmin lidhur me nenin 31 dhe lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave, siç janë: me pëlqimin e të gjitha palëve ka lexuar deklaratat e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve të dëgjuar më parë ashtu që janë lexuar: Deklarata e dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve të dhëna në faza të procedurës ku të njëjtit kanë parashtruar prova dhe dëshmi për lidhje të kontratave si dhe dëshmi për pagesa të bëra si dhe kanë paraqitur kërkesat e tyre për dëmshtëpërlim.

Deklaratat e dëshmitarëve: J.Gj, V.V, S.K, A.O, të dhëna në seancën e dt.31.05.2021; Deklaratat dëshmitarëve D.B, L.G, I.D dhëna në seancë të dt. 30.11.2021.

Janë lexuar këto prova materiale; Raporti final i hetuesve të njësisë se hetimeve financiare pranë ATK-se me numër 84/2016 i datës 16.03.2016; Kontrate për ndërtimin e përbashkët të kompleksit të lokaleve afariste dhe banesave – pronaret (I.D, L.G, A.V) dhe E.B 15.04.2009; Njoftim për pezullim të kontratës të lidhur për bashkë investim në ndërtimin e përbashkët të kompleksit të lokaleve afariste dhe banesave 12.05.2010; Marrëveshje mbi shkëputjen e kontratës për ndërtimin e përbashkët të kompleksit të lokaleve afariste dhe banesave I.D, E.B dhe XH.A 15.06.2011, është shkëput kontrata e dt.07.05.2009; Marrëveshje mbi shkëputjen e kontratës në mes të B.B, E.B dhe XH.A 27.05.2009; Aktvendim mbi caktimin e kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimorë: B.M,A.V, B.B, I.D, B.M, S.Z, L.G, A.S dhe N.S dhe investitori Venis O Group 25.06.2010; Konkluzion A.G dhe NPN Hoxha 01.03.2012; Autorizim Venis O Group -XH.A 03.06.2011;Deklarate në mes të E.B dhe XH.A 01.08.2011;Marrëveshja mbi shkëputjen e kontratës për ndërtimin e përbashkët ne mes te I.D, E.B dhe XH.A 15.06.2011; Kontrata mbi ndërtimin e përbashkët ne mes te I.D, L.G, S.Z, A.V06.03.2012; Aktvendim u lejohet ndërtimi i objektit ne mes te I.D, L.G, S.Z, A.V me investitor A.G me përfaqësues D.B 12.02.2013; Aneks kontrata I.D,L.G, S.Z, A.V, B.M, N.S, A.S, I.D; B.B dhe E.B 15.04.2009; Kërkesë e dt.14.05.2013; Informim lidhur me kërkesën e kompanisë ndërtimore Venis O Group te përfaqësues nga E.B 21.05.2013; Informate nga Plani rregullues Mati 1 dt.10.06.2009; Konkluzion para projekti dt. 11.08.2009; Konkluzion zgjedhja e projektit ideor si faza e parë në kompleksin Venis O Group 05.12.2009; Leje urbanistike dt.07.08.2009; Deklarate mbi participimin e ndërtimin e objektit afaristo banesor ne mes te pronareve te tokave, E.B dhe Xh.A 08.09.2009; Kontrate -marrëveshje për kompensim ne mes te A.G dhe XH.At 10.10.2012; Leje ndërtimi dt.11.06.2010 (dosja); Kërkesë për marrjen e informative 14.06.2013;

Procesverbalet mbi marrjen ne pyetje te dëshmitarëve S.Z, L.G, N.S, I.D 24.10.2014 dhe 23.10.2014; Njoftim nga ARBK 25.06.2013, Përgjigje për kërkesë nga ATK -Venis O Group," Era" N.SH.N dhe Hamburger "....." 25.06.2013; Informim nga Komuna e Prishtinës 05.06.2014; Kërkesë për marrjen e informatave 14.06.2013;Certifikate e regjistrimit te biznesit Venis O Group 14.10.2009; Kontrate për transferimin e pronësisë dhe shuarjen e borxhit ref. 196-45/2013; Parakontratë për shitblerjen e banesës 24.10.2007; Kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë ne mes te B.G dhe A.B 23.06.2008; Aktvendim i caktohet taksa në transaksion te pronës se patundshme në shumë prej150 euro, A.B14.08.2008; Kopje e planit -Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe te mbrojtjes dhe mjedisit 10.09.2008; Transaksion ne mes te E.B dhe V.O neper mes W...U... 05.11.2007, Flete dërgesë 23.05.2013; Certifikate martese ne mes te A.B dhe Xh.B 20.04.2011; Kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë ne mes te XH.A dhe M.. T.G.H 6 shkurt 2009 dhe e dorëzuar në prokurori me dt.10.04.2015; Marrëveshje ne mes të F.Xh dhe E.B 22.05.2013; Kontrate për ndërtimin e përbashkët të kompleksit te lokaleve afariste dhe banesave M.B dhe E.B 02.03.2009; Kontrate për ndërtim të përbashkët te kompleksit te lokaleve afariste dhe banesave ne mes te N, S, A, R, H.A dhe E.B 19.04.2012; Kontratat e anuluar qe janë kthyer mjetet; Parakontrate e dt.23.01.2010 mbi shitblerjen e paluejtshmerise -banese ne mes shitëses: E.B A.B dhe blerësit R.Z dhe deklarate dt.26.01.2010; Parakontrata mbi shitblerjen e paluejtshmerise-banesës e E.P dt.17.05.2011; Parakontrate mbi shitblerjen e paluejtshmerise dt.16.09.2010, dhe Konfirmim i transaksionit i dt.16.09.2010 dhe Kopje e letërnjoftimit Anulim i parakontratës me deklarate dt.25.07.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e paluejtshmerise banesës B.M dt.26.10.2010, me kopje e letërnjoftimit F.K–M dhe kopje e letërnjoftimit te B.M, konfirmim i transaksionit dt.26.10.2010; Deklarate dt.27.10.2010 konfirmim i transaksionit Deklarate dt.02.11.2010; Deklarate dt.19.11.2011; Konfirmim i transaksionit; Konfirmim i transaksionit, Konfirmim i transaksionit, Dëftese dt.02.11.2010,26.10.2010 dhe 27.10.2010; Para kontrate mbi shitblerjen e paluejtshmerise se banese te E.Gj dt.17.11.2010, Deklarate dt.19.11.2010, Konfirmim i transaksionit dt.17.11.2010, Deklarate dt.10.10.2011. deklarate qe tregon kthimi i mjeteve ne llogarinë e E.Gj e njëjta nuk përmban datë; Aneks kontrata dhe deklarata për kthimin e mjeteve ne vlere prej 11.000.00 euro, ne llogari te F.B dt.18.05.2012, Kopja e letërnjoftimit te F.B, Para kontrate e S.Bt dt. 21.09.2010, Konfirmim i transaksionit dt.21.09.2010, Deklarate dt.21.09.2010; Parakontratë e paluejtshmerise se banesës për L.D dt.08.05.2010, Deklarate dt.01.07.2010; Parakontratë mbi shitblerjen patundshmërisë banesës për A.S dt.08.02.2010 kopja e letërnjoftimit, Deklarate dt.09.02.2010 për pranimin e marrjes se shumës se të hollave prej 10.000 euro, dëftesë dt.09.02.2010 për pagesës se shumës e lartcekur, Konfirmim i transaksionit dt.08.02.2010.; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë M.K dhe I.N dt. 20.02.2010 Kopja e letërnjoftimit te M.K, Para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë ne emër te I.N dt.10.09.2009, Deklarate dt.04.12.2009, Transaksionet bankare dt.27.07.2011, Deklarate dt.27.07.2011, vërtetim dt. 10.09.2009, Urdhër pagese kombëtare dt.22.02.2010, Vërtetimi i I.N dt.10.09.2009, Deklarate dt.10.03.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës në emër të A.H dt.02.02.2011, Konfirmim i transaksionit prej 10.000 euro, dt. 02.02.2011 kopja e letërnjoftimit te A.H, Deklarate -Konfirmim i transaksionit prej 300 dhe dëftesë prej 100 euro; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës në emër të A.A, Deklarate dt.04.02.2011, Dëftese dt.04.08.2009, Para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës ne emër të A.A dt.25.01.2010, Deklarate dt.26.01.2011, Dëftese dt.26.01.2011, Konfirmim i transaksionit prej 10.000 euro dt. 25.01.2010, Kopja e letërnjoftimit te A.A dhe Kopja e letërnjoftimit te K.I.A; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës se A.G dt.20.12.2010, -Kopje e letërnjoftimit; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës për G.H Hoti dt. 01.06.2010, Deklarate dt. 15.11.2010, Deklarate për kthimin e mjeteve dt.18.07.2011, Konfirmim i transaksionit

prej 8.850 Konfirmimi i transaksionit 8900 dt.18.07.2011, Konfirmim i transaksionit V.H 200 euro dt.16.09.2001 Kopja e ID kartës te G.H Hotit Kopja e letërnjoftimit te V.H Kopja e letërnjoftimit te G.H. Konfirmim i transaksionit V.H 100 euro Konfirmim i transaksionit V.H 100 dt.20.07.2011 dhe 16.03.2010, Konfirmim i transaksionit V.H 100 euro dt.14.02.2011, Konfirmim i transaksionit V.H 100 euro dt.18.01.2011, Konfirmim i transaksionit V.H 100 euro dt.15.12.2011, konfirmim transaksionit V.H 100 euro dt. 10.11.2011, konfirmim i transaksionit V.H 200 euro dt. 16.09.2010.

Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë se banesës L.A Ahmeti 23.08.2010, Deklaratë dt.23.08.2010, Konfirmim i transaksionit prej 6.000 euro dt.23.08.2010, Kopja e letërnjoftimit te L.A Ahmeti dhe A.A; Kopja e ID kartes se SHPK; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banese A.C 17.06.2011, deklarata, Aneks kontrate dt.20.04.2012, Aneks kontrate A.C dt.13.07.2012, Deklarate dt.25.10.2011; Parakontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës se V.L dt.19.03.2010, Konfirmim i transaksionit prej 10.000euro dt.19.03.2010, Deklarate dt.31.03.2010 dhe Kopja e letërnjoftimit te V.L; Parakontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës te E.V dt.30.08.2010, Transferimi bankar dt.01.09.2010, Deklarate dt.01.09.2010 Kopja e letërnjoftimit te E.V; Parakontratë mbi shitblerjen e paligjshmërisë banesës F.H dt.23.11.2009 Kopja e letërnjoftimit, dëftesë pagesë me vlere prej 24.000 euro dt. 23.11.2009; Prokurë e posaçme dt.23.02.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës për S.K.F dt.13.02.2012 dhe Deklarate, Aneks kontrate dt.19.12.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë për J.Dj dt.31.12.2010, kopje e letërnjoftimit te D.D Kopje e letërnjoftimit te J.D, Deklarate dt.17.01.2011, dëftese dt.17.01.2011, konfirmim i transaksionit bankar dt.11.01.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës për Sali Berisha dt.11.12.2009, kopja e letërnjoftimit, Deklarate dt.17.12.2009, Deklarate dt.20.08.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës L.P dt.18.11.2010, Deklarate, Kopja e letërnjoftimit te L.P, Kopja e letërnjoftimit te A.P Krasniqi, Deklarate dt.07.08.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë për D.L dt.19.03.2010, Deklarate 31.03.2010, Kopje e letërnjoftimit D.L, Kopje e letërnjoftimi te R.L; Anulim i parakontratës se H.L, Deklarate dt.31.11.2010, Kopje e letërnjoftimit i H.L, Para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë për H.L dt.04.12.2010, Para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës dt.19.05.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë M.S 24.02.2012, kopja e letërnjoftimit te M.S dhe Deklarata; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës Sh.K dt.11.01.2011 Sh.K dt.01.02.2010, Deklarata e Sh.K dt.13.01.2010, kopja e letërnjoftimit Sh.K; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës për A.K dt.11.01.2011, Konfirmim i transaksionit bankare të A.K në shumën prej 9000euro dt.29.01.2010, Urdhërpagese kombëtare nga, deklarate dt.18.02.2010, deklarate dt.26.09.2011, deklarate dt.26.01.2010, deklarate dt.01.08.2011, aneks Kontrate dt.30.07.2012, deklarate në emër të A.K dt.20.03.2012, Marrëveshje për kthimin e borxhit dt.21.02.2012, parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës për A.K dt.25.01.2010, para kontrate në emër te A.K 09.01.2010, Deklarata e A.K dt.13.01.2010; Parakontratë në emër të A.J dt.23.08.2010, Kopja e patente shoferit, Deklarate e A.J dt. 23.08.2010, Konfirmim i transaksionit bankar në shumen prej 10.000euro dt. 23.08.2010, deklarate dt.23.02.2010, para kontrate e A.J dt.06.12.2010, Kopja e letërnjoftimit, Deklarate dt.14.12.2010, deklarate dt.23.02.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës B.P dt.20.12.2010, deklarate dt.22.12.2010, Deklarate e B.P dt.16.03.2011, Kopje e letërnjoftimit;

-Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë Muhamet Sylejman dt.07.03.2012, Kopja e letërnjoftimit të M.S, deklarate dhe Aneks kontrate dt.31.07.2012; Kopje e letërnjoftimit të S.B Para kontrate e shitblerjes se

patundshmërisë banesës S.B dt.10.11.2011, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës S.Bdt.25.05.2011, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se S.B dt.26.04.2011;Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës F.G dt.27.01.2011, Deklarate dt.22.03.2011; Parakontratë për shitblerjen e patundshmërisë se Sh.G dt.02.12.2011, deklaratë e Sh.G dt.02.12.2011, kopja e letërnjoftimit; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës se A.S dt.17.05.2011, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës A.S, deklarate dt.14.09.2010, kopja e letërnjoftimit te A.S, aneks kontrata dt.17.04.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës se Xh.B dt.17.05.2011, para kontrate mbi shitblerjen e banesës se Xh.B dt.14.05.2010, Kopja e letërnjoftimit te Xh.B, Konfirmim i transaksionit bankarë te Xh.B për Shumen 3000 euro dt.14.05.2010, Konfirmim i transaksionit bankare te Xh.B për Shumen 2000 euro dt.19.05.2010. Flete pagese N.. Bankes 3000 euro Deklarate dt.14.05.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës për M.U dt.07.06.2011, deklarate dhe Dëftesës dt.10.03.2011, konfirmim i transaksionit bankare për Shumën prej10.000 euro dt.07.03.2011, para kontrate mbi shitblerjen e banesës dt.07.03.2011, aneks kontrate dt. 08.06.2012, aneks kontrate dt.11.07.2012 dhe Kopja e letërnjoftimit të M.U; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës në emër të A.H dt.03.05.2011, dëftese, deklarate dt.05.05.2011, deklarate dt.04.05.2011, aneks kontrate dt. 31.07.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë se L.Mt dt.22.11.2010, konfirmim i transaksionit bankare për shumen prej 10.000 dt.23.11.2010, kopje e patente shoferes, deklarate dt.24.11.2010;

Kontratat e anuluar që nuk janë kthyer mjetet

Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmerise banese ne mes shitëses: E.B, A.B dhe blerësit E.U dt.13.01.2011, parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës 16.05.2011, dëftesë nga sekretariati i KGJK-se dt.17.01.2011, kopja e letërnjoftimit te E.Ut Konfirmim i transaksionit në bankë dt.23.01.2010; Konfirmim i transaksionit bankar ndërmjet R.N dhe V...O... SH.P.K, Aneks Kontrata e dt.17.05.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës ndërmjet E.B dhe T.P dt.06.09.2010, Kopja e letërnjoftimit te T.P, deklarate e E.B Bunjakut dt.07.09.2010; Parakontratë e shitblerjen e patundshmërisë-banesës ndërmjet E.Bt dhe G.M dt.17.11.2010, deklarate e E.Bt dt.30.11.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banese ndërmjet E.B dhe A.G dt.11.01.2012, Deklarate e E.B. konfirmim i transaksionit bankar ndërmjet A.G dhe V...O..., dt. 11.01.2012, Fotokopja e letërnjoftimit të A.G; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës ndërmjet E.B dhe R.M dt.08.06.2010, para-kontrate mbi shitblerjen e banesës ndërmjet E.B dhe R.M dt. 31.05.2011, konfirmimi i transaksionit ndërmjet R.M dhe E.B dt. 08.06.2010, Kopje e letërnjoftimit te R.M, deklarate e E.Bt dt.22.06.2010, Kopje e letërnjoftimit te M.M; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë -banese E.B dhe F.E dt.03.06.2011, Konfirmim i transaksionit bankar dt.03.06.2011, Kopje e letërnjoftimit te F.E, Deklarate e E.B; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës nga E.B dhe F.H dt.08.08.2011, para-kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës dt.17.08.2010, kopje e letërnjoftimit te F.H, Kopja e ID te punës ne SHPK, Urdhër pagese kombëtare ndërmjet E.H për E.B dt.18.08.2010, urdhërpagesë kombëtare, ndërmjet A.H për E.B dt.06.09.2010, urdhërpagesë kombëtare ndërmjet E.H për E.B dt.18.08.2010, konfirmim i transaksionit në ratën e trete e A.H dt.09.12.2010, konfirmim i transaksionit ndërmjet A.H dhe E.B dt.03.03.2010, urdhër pagese kombëtare ndërmjet A.H dhe E.R II dt.20.10.2010, aneks kontrata dt.27.06.2012, deklarate e E.B dt.23.08.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës ndërmjet Sh.A dhe E.B dt.22.10.2010, deklarate e E.B dt.26.10.2010, Konfirmim i transaksionit bankar të Shukri Aliut dt.22.10.2010. Parakontratë mbi shitblerjen e paluejtshmerise-banesës ndërmjet Zymer Halimi dhe E.B dt.22.08.2011, kopja e letërnjoftimit të Z.H, Kopja e ID

të forcës së sigurisë së Kosovës, Konfirmim bankar dt.22.08.2011, deklaratë e E.B dt.29.08.2011;Parakontratë mbi shitblerjen e paluejtshmerisë-banesës E.B dhe Rr.B, i dt.29.08.2011, deklaratë e E.B, deklaratë e E.B për kthimin e mjeteve të Rr.B dt.30.05.2013; Parakontratë mbi shitblerjen e paluejtshmerisë -banesës ndërmjet E.B dhe B.H dt.01.11.2011, Kopje e letërnjoftimit të B.H ,Kopje e letërnjoftimit të R.H, deklaratë e E.B dt. 01.11.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës për A.M nga E.Bn dt.17.06.2010, Kopje e letërnjoftimit të A.M., deklaratë e E.B dt.08.07.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës ndërmjet P.Lt dhe E.Bt dt.15.11.2010, para-kontrate e P.Lt dhe E.Bt dt.27.02.2012, Kopje e letërnjoftimit të P.Lt.; Parakontratë mbi shitblerjen e paluejtshmerisë-banesës ndërmjet E.B dhe I.H, dt.11.03.2011, konfirmim i transaksionit dt.12.03.2011, kopja e letërnjoftimit I.H, Deklaratë e E.B dt.15.03.2011, Dëftese dt.06.03.2011, Kopje e ID, policisë; Kontratë për shitblerjen e patundshmërisë në mes të kompanisë "....." dhe A.M dt.02.09.2009, Kopja e lejes së vozitjes; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës të E.Bt dhe B.S dt. 22.03.2010, urdhërpagesë kombëtare dt. 22.03.2010 , Kopja e letërnjoftimit, deklaratë e E.B dt.13.04.2010, aneks kontratë dt.24.12.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e paluejtshmerisë-banese E.B dhe N.P dt.16.05.2011, dëftesë dt.23.05.2011, Kopja e letërnjoftimit të N.P, deklaratë e E.B dt.23.05.2011; Parakontratë për shitblerjen e patundshmërisë-banesës në mes të E.B dhe J.P dt.11.01.2011, konfirmim i transaksionit dt.12.01.2011, Kopja e letërnjoftimit të J.P, deklaratë e E.B dt.17.01.2011, dëftesa dt.17.01.2011; Parakontratë e shitblerjes së patundshmërisë-banesës në mes të E.B dhe N.Ll dt.15.09.2009, konfirmim i transaksionit dt. 31.12.2009, deklaratë dt.30.08.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës të E.B dhe M.G dt.08.09.2010, para kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë -banesës 17.05.2011, deklaratë e E.B dt.10.09.2010, Kopja e letërnjoftimit të M.G, urdhërpagesë kombëtare dt.10.09.2010, urdhërpagesë kombëtare dt.08.09.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës në mes të E.B dhe A.M dt.31.12.2009, mandat arkëtimi -bankar Kopje e ID të A.M dt.14.07.2010, urdhërpagesë kombëtare dt.31.12.2009, deklaratë dt.30.08.2010, urdhërpagesë kombëtare dt.09.01.2009; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës në mes të E.Xht dhe Estrid Bunjaku dt.03.06.2011, konfirmim i transaksionit bankar 06.06.2011, Kopja e letërnjoftimit të E.Xht, deklaratë e E.B dt.08.06.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës në mes të M.B dhe E.B dt.16.05.2011, Dëftese 23.05.2011, Kopja e letërnjoftimit të M.B, Deklaratë e E.B; Parakontratë e shitblerjes së patundshmërisë-banesës në mes të Valon Sadikut dhe E.B dt.12.08.2010, deklaratë dt.13.08.2010, Kopja e letërnjoftimit të Valon Sadikut; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës së T.B dhe E.B dt.26.10.2009; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës B.P dhe E.B dt.21.03.2011, Kopja e letërnjoftimit të B.P, Kopja e ID kartës së punës, urdhërpagesës kombëtare dt.21.03.2011, urdhërpagesë kombëtare dt.22.03.2011, dëftesa dt.23.03.2011, deklaratë dt.22.03.2011; Parakontratë për shitblerjen e patundshmërisë-banesës në mes të B.Gt dhe E.B dt.12.08.2010, para kontratë për shitblerjen e paluejtshmerisë-banesës në mes të B.Gt dhe E.B e nënshkruar me datën dt.22.05.2011, konfirmim i transaksionit bankar dt.13.08.2010, kopja e letërnjoftimit të B.G, deklaratë dt.23.08.2010; Parakontratë e patundshmërisë-banesës në mes të A.D dhe E.B dt.04.10.2011, deklaratë dt.05.10.2011; Parakontratë për shitblerjen e patundshmërisë-banesës në mes të S.S dhe E.B dt.17.05.2011, para kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë në mes të S.S dhe E.B e nënshkruar me Aneks kontratë dt.19.05.2011; Parakontratë e patundshmërisë-banesës në mes të A.Ç dhe E.B dt.05.11.2010, para kontratë për shitblerjen e patundshmërisë në mes të A.Ç dhe E.B dt.17.05.2011, Aneks kontratë dt.18.06.2012; Para kontratë për shitblerjen e banesës në mes të Sh.P dhe E.B dt.13.12.2010, Kopje e letërnjoftimit të Sh.P, Konfirmim i transaksionit dt.28.12.2010, aneks kontratë dt.16.07.2012; Para kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës në mes të

Sh.K dhe E.B dhe është nënshkruar me dt.16.05.2011, Deklarate e E.B, Kopje e letërnjoftimit, Formulari për urdhëresën e pagesës dt.16.05.2011, Konfirmimi i transaksionit dt.16.05.2011, Deklarate e E.B dt.13.04.2010, Konfirmim i transaksionit bankar dt.01.04.2010, Kopje e letërnjoftimit; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës ne mes të Sh.K dt.22.09.2009, deklarate dt.14.12.2010, Aneks kontrate, Aneks kontrate 25.06.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e paluejtshmerisë-banesës ne mes të Z.P dhe E.B dt.14.01.2011, Kopje e letërnjoftimit të Z.P,deklarate dt.17.01.2011, Dëftesë dt.17.01.2011, konfirmim i transaksionit dt.21.01.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës ne mes të I.G dhe E.Bt dt.21.05.2010, Kopja e letërnjoftimit të L.K, Kopja e letërnjoftimit te I.G, dëftese dt.17.01.2011, deklarate e E.B dt. 17.01.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë ne mes të B.St dhe E.B dt. 12.04.2010, Kopje e letërnjoftimit te B.S, deklarate e E.B dt.13.04.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës në mes të B.Sh dhe E.B dt.12.04.2010, Kopje e letërnjoftimit, deklarate dt.13.04.2010, urdhërpagesë kombëtare dt.12.04.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës e N.LI dhe E.Bt 15.04.2010, Kopje e letërnjoftimit të N.L, konfirmim i transaksionit bankar dt.27.04.2010, table e bankës Raiffeissen me vlere 7.000,00 euro dt. 27.04.2010, deklarate e E.B 11.05.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës ne mes të G.N dhe E.B dt.19.11.2011. Para kontrate ne mes te G.N dhe E.B dt.02.06.2011, dëftesës dt.22.11.2010, Kopje e letërnjoftimit te G.N, konfirmim i transaksionit 19.11.2010, deklarate dt.22.11.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë ne mes te R.K dhe E.B dt. 03.02.2011, Kopja e letërnjoftimit te R.K, konfirmim i transaksionit bankar 03.02.2011, deklarate dt. 04.02.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se L.B dt.01.02.2010, Kopja e letërnjoftimit te L.B, Kopja e letërnjoftimit te A.B, konfirmimin e transaksionit në shumën prej 2500, dt.01.02.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës Xh.Xh dt.17.05.2011, aneks kontrate dt.10.07.2012, deklarate; Para kontrate mbi shitblerjen e banesës në emër të Xh.Xh dt.23.08.2010, deklarate dt.23.08.2010, Kopja e letërnjoftimit te Xh.Xh, kopja e ID Cardes SHPK te Xh.Xh; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës M.S.E, deklarate, kopja e letërnjoftimit te M.S.E, kopja e letërnjoftimit te L.E, para kontrate mbi shitblerjen e banesës se Xh.S dt. 16.05.2011, para kontrate mbi shitblerjen e banesës se Xh.S dt. 19.04.2010, kopja e letërnjoftimit te Xh.S, kopja e ID se punës ne SHPK, aneks kontrate dt. 26.07.2012, faqe me llogaritjet e Xh.S; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se Xh.K dt.11.09.2010, kopje e letërnjoftimit te Xh.K, aneks kontrate, deklarate dt.14.09.2010, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës se Xh.K dt.10.11.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se Xh.B dt.17.05.2011, konfirmim i transaksionit bankar në Shumen prej 297 euro i Xh.B dhe 15.000 euro i T.B dt.11.10.2010; 27.08.2010, konfirmimi i transaksionit bankar ne shumën prej 297 euro dt.10.11.2010; Para kontrate mbi shitblerjen e banesës se Xh.B dt.14.05.2011, 26.08.2010, kopja e letërnjoftimit te Xh.B, kopja e letërnjoftimit te T.B, deklarate dt.30.08.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se I.R dt.10.08.2011, deklarate, kopja e letërnjoftimit I.R, kontrate e marrëdhënies se punës dt.01.06.2010, deklarate dt.14.11.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se H.Th Qershor 2012, kopja e letërnjoftimit te H.Tht, deklarate dt.10.05.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se H.K dt.05.10.2011, kopja e letërnjoftimit te H.K, deklarate; Parakontratë mbi shitblerjen e paluejtshmerisë-banesës H.D dt.19.05.2011, aneks kontrate, kopja e letërnjoftimit, deklarate dt.22.03.2010, aneks kontrate; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se I.H dt.19.05.2011, dëftesë dt. 23.05.2011, deklarate; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se I.K dt.30.05.2011, kopja e letërnjoftimit te E.B, kopja e letërnjoftimit te I.Kt, deklarate e I.Kt, dëftese dt.31.05.2011, urdhërpagesë kombëtare dt.30.05.2011, aneks kontrate dt.17.07.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e

patundshmërisë-banesës se I.Kt dt.11.11.2011, deklarate e I.Kt dhe F.K Kopranit: Parakontratë mbi shitblerjen e banesës I.B dt.17.05.2011, aneks kontrate, kopja e letërnjoftimit të I.B, kopja e letërnjoftimit të L.A transferet dërguese të L.A dt. 08.04.2010, deklarate I.B dt.13.04.2010, Para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës në emër të I.Bt dt.01 .04.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se M.Kt dt.03.11.2011, konfirmim i transaksionit në emër të M.K në shumën prej 9900 euro dt.04.11 .2011, kopja e pasaportës se M.Kt, kopja e letërnjoftimit të M.Kt, kopja e xhirrollogarisë se E.B të Venis- O Group, deklarate 10.000, deklarate 5.000 dt.02.12.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se M.C dt.29.08.2011, deklarate, kopja e letërnjoftimit, kopja e kartelës se V...O... Plani i banesës, konfirmim i transaksionit në shumën prej 10.000 euro dt.29.08.2011, konfirmimi i transaksionit në shumën prej 200 euro dt.19.10.2011, konfirmim i transaksionit në shumën prej 200 euro dt.27. 12.2011, konfirmimi i transaksionit në shumën prej 200 euro dt.19.11.2011, konfirmim i transaksionit në shumën prej 600 dt.13.04.2012, një flete e shkruar nga E.B dt.30.03.2014; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës Nexhat Dushi dt.04.10.2011, Deklarate, kopja e letërnjoftimit të N.D; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës N.M dt.09.08.2010, deklarate dt.13.08.2010, kopja e letërnjoftimit të N.M vendim për pensionin të invalideve të UQK-se dt.19.04.2010, kopja e ID cardes se SHPK; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës dt. 16.09.2011, Parakontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banese se R.S dt.06.01.2010.Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se S.S, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se S.S dt.06.01.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës se S.Sh dt.06.01.2010, Kopja e pasaportës se S.Sh, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se S.Sh dt.15.06.2009, kopja e letërnjoftimit të S.Sh; Parakontratë mbi shitblerjen e paluejtshmerise-banesës S.Z dt.08.10.2011, Deklaratë; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës S.M dt.01.02.2011, Para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës se S.M dt.19.05.2011, kopja e letërnjoftimit të S.M, deklarate dt.04.03.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës S.H dt. 19.05.2011, aneks kontrate, parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se S.H dt. 12.06.2010, kopja e letërnjoftimi të S.H, deklaratë, konfirmim i transaksionit në shumën prej 8.000 euro dt.19.07.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës se S.M dt. 05.08.2011, deklarate dt.15.11.2010, para kontrate mbi shitblerjen e banesës se S.M dt.08.11.2010, kopja letërnjoftimit të Zvicrës se S.M dhe V.M, konfirmim i transaksionit të S.M në shumën prej 9900 euro dt. 08.11.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës se S.Xh dt.08.08.2011, para kontrate mbi shitblerjen e banesës S.Xh dt.14.09.2010, konfirmim i transaksionit në shumën prej 5000 euro dt.14.09.2010, konfirmim i transaksionit në shumën prej 3000 euro dt.09.11.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës se S.M dt. 06.09.2010, Deklarate dt.07.09.2010, kopja e letërnjoftimit, konfirmimit të transaksionit në shumën prej 10.000 euro dt.07.09.2010, parakontratë mbi shitblerjen patundshmërisë-banesës S.M dt.10.0.2011, kopja e ID Cardes se punës SHPK; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës se Sh.S dt.13.07.2011, kopja e letërnjoftimit të O.S, kopja e letërnjoftimit të Sh.S, deklaratë; Parakontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se Sh.S dt.22.04.2010, kopja e letërnjoftimit të Sh.S, deklarate dt.11.05.2010, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës se Sh.S dt.20.09.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banese se Sh.Sh dt.31.10.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës V.D dt.17.03.2010, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë se banese V.D dt.22.05.2011, aneks kontrate, kopja e letërnjoftimit të V.D, deklarate dt.22.03.2010, konfirmim i transaksionit në shumën prej 1.100 euro. dt.17.03.2010;Parakontratë mbishitblerjen e patundshmërisë-banesës se Z.J dt.08.10.2011;Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se V.M dt. 30.12.2010, konfirmimi i transaksionit në shumën prej 10.000

euro dt.30.12.2010, kopja e letërnjoftimit të V.M, Deklarate dt.30.12.2010, Aneks kontrate dt.06.04.2012 .

Kontrata të vazhduara

Kontrata për ndërtimin e përbashkët të Kompleksit të lokaleve afariste dhe banesave në mes të E.Bt dhe N.S dhe R.A dt.19.04.2012; Vërtetim nga Drejtoria e financave dhe pronës dt. 10.05.2012; Certificate njësia kadastrale dt.10.05.2012, Parcela ne shfrytëzim tabele dt.29.05.2012, kopje e planit dt.02.03.2012, certifikatë njësia kadastrale dt.15.03.2012, vule e protokollit dt.29.05.2012; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës A.S dt.05.08.2011, para kontrate mbi shitblerjen e banesës dt.26.10.2010, deklarate dt.26.10.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës për L.P dt.29.12.2010, kopja e letërnjoftimit të L.P, deklarate dt.30.12.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës të A.K dt.29.12.2010, konfirmim i transaksionit A.K në shumen prej 9500 euro dt.29.12.2010, kopja e letërnjoftimit të A.K, deklarate dt. 30.12.2010, Deklaratë dt.30.04.2012, aneks kontrate; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës për M.B dt. 20.07.2011, konfirmim i transaksionit ne shumen prej 12.400 euro dt.20.07.2011, deklaratë; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës N.S dt.18.07.2011, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë dt.13.08.2010, deklarate, deklarate dt.22.08.2010, kopja e letërnjoftimit të N.S, deklarate dt. 17.01.2011; Para kontrate mbi shitblerjen e banesës se A.K dt. 31.05.2011, para kontrate mbi shitblerjen e banesës A.K dt.03.03.2010, kopja e letërnjoftimit të A.K, Kopja e letërnjoftimit të V.M.K, konfirmim i transaksionit ne shumen prej 11.500 dt. 04.03.2010, formulari mbi urdhëresën për pagesë shumën prej 140 dollar dt.15.03.2010, deklarate dt.10.03.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se A.B dt.17.05.2011, para kontrate mbi shitblerjen e banesës se A.B dt.26.02.2011, kopja e letërnjoftimit të A.B, deklarate dt.04.03.2011, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës A.B; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës A.V dt.06.04.2010, konfirmim i transaksionit ne shumen prej 5000 euro dt.07.04.2010, kopja e letërnjoftimit të A.V, deklarate dt.13.04.2010, konfirmim i transaksionit ne shumen prej 5000 euro dt.12.04.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës B.K; Parakontratë mbi shitblerjen banesës se Q.R dt.17.06.2010, kopja e letërnjoftimit të Q.R ne gjuhen serbo-kroate, konfirmim i transaksionit në shumen prej 10.000 euro dt.17.06.2010, deklarate dt.01.07.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banese se Q.R dt.31.10.2011, kopja e xhirollogarisë bankare; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës Q.K dt.20.10.2010, konfirmim i transaksionit në shumen prej 2000 euro dt.20.10.2010, deklarate dt.26.10.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës se D.B dt.17.06.2011, kopja e letërnjoftimit të D.B, deklaratë; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës se E.Kt datë Nentor 2010, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë se E.K dt.11.01.2010, deklarate; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës E.S dt.18.03.2010, deklaratë dt.22.03.2010, deklarate dt.11.05.2010, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës dt.25.05.2011, kopja e letërnjoftimit të E.St, Tabele e shumave të paguara nga E.S, aneks parakontratë, tansfere bankare në shumën prej 8000 euro dt.18.03.2010, transfer bankar ne Shumen prej 2000 euro dt.18.03.2010, konfirmim i transaksionit Shumen prej 8000 dt.27.04.2010, transfer bankar në shumën prej 1500 dt. 15.04.2010, ankesë kontrate 16.000; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se E.F dt.13.04.2010, kopje e letërnjoftimit Kopja e ID cardes, Para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë dt.17.05.2011, aneks kontrate deklarate dt.11.05.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës F.E dt. 16.05.2011, aneks kontratë; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës dt.06.09.2010, konfirmim i transaksionit në shumën prej 171 euro dt.12.10.2010, kopja e letërnjoftimit të F.E, kopja e ID Cardes se F.E deklarate dt. 07.09.2010, konfirmim i transaksionit në shumën prej 5000 euro dt.07.09.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës F.Zh

dt. 23.05.2010, konfirmim i transaksionit ne Shumen prej 6000 dt.28.05.2010, kopja e ID cardes se F.Zh, kopja e letërnjoftimit të F.Zh, deklarate dt.31.05.2010; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës F.D dt.22.08.2011, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës dt.26.08.2010, deklarate dt. 30.08.2010, konfirmim i transaksionit në shumen prej 10.000 euro dt. 26.08.2010, formular mbi urdhëresën e pagesës ne Shumen prej 181euro dt. 26.08.2010, kopja e dokumentit personal të F.D, kopja e dokumentit personal S.D; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se F.Zt dt.23.01.2010, dëftese e formularit për ndërrimin e te dhënave dt.konfirmimi i transaksionit në Shumën prej 3000 euro dt.23.01.2010, deklarate dt.26.01.2010, deklarate dt.24.11.2010, aneks kontrate, deklarate; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë banesës F.Sh dt.29.04.2011, kopje e letërnjoftimit të F.Sh, deklarate dt.03.05.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës se D.Bt dt.17.05.2011, para kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës dt.06.09.2010, kopje e pasaportës se A.B, kopje e pasaportës se D.Bt, kopje e transferit në shumen prej 50.000 euro dt. 03.09.2010, deklarate e A.Bt dt.07.09.2010, kopje e pasaportës se Sh.B; Parakontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë-banesës A.M.K dt.08.04.2011, deklarate dt.12.04.2011, kopje e letërnjoftimit te A.M.K, kartele e Teb Bankës në shumen prej 18.616.00 euro, aneks kontrate dt.21.06.2012, kopja e kartelës bankare; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës se A.I dt.08.11.2011, kopja e letërnjoftimit të N.B; Parakontratë mbi shitblerjen e banesës se V.B dt.01.06.2011, Kopja e letërnjoftimit te Y.F; Deklarate e D.O dt.27.06.2011; N.M Deklarate dt.16.09.2011; S.B Deklarate dt.15.03.2013. Prokure e posaçme e S.B dt. 23.02.2012.

Deklarata e të pandehurës E.B e dhënë në SHPK, dt.24-27.01.2014; Deklarata e të pandehurës E.B e dhënë në PTH, dt.11.09.2014; Deklarata e të pandehurës E.B e dhënë në PSRK, dt.07.04.2015; Deklarata e dëshmitarëve të dhëna në faza të procedurës.....; Parakontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë-banesës, e lidhur ndërmjet A.H dhe E.R dhe E.B, dt. 16.05.2011; Parakontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë-banesës, e lidhur ndërmjet Melihate Shaqiri dhe E.B, dt. 11.06.2010; Parakontratë e lidhur ndërmjet G.H dhe E.B, Deklaratë e E.B, transaksionet Bankare dhe Letërnjoftimi i G.H.

Raporti policor mbi zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, Urdhëresa PN.nr.14/14, biseda ndërmjet E.B dhe të tjerëve, Raporti dt. 28.02.2014; Shënim Zyrtar dt. 01.04.2014, lidhur me kontaktet e E.B me persona tjerë, në kuadër të zbatimit të masave të fshehta; Foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës; Deklarata e E.Bt, datë 23.09.2009 dhe marrësi i deklaratës B.V; Ankesë nga Xh.B dhe T.B, datë 30.06.2014; Raportet policore të dt.15.07.2013, 12.09.2013, 29.08.2013, 24.12.2013, të policit A.B; Raporti i Bankës BKT dt.29. Gusht 2013, Bankës Ekonomike 30.08.2013, raporti i N.. Bankës dt.01.09.2013, raporti i TEB Bankës dt.02.09.2013, Raporti i Raiffaizen bankës i dt.04.09.2013, të marra sipas urdhëresës PPN.nr. ..., si dhe detajet e llogarive bankare Pro Credit banke për dy llogari te E.B dhe Venis O Grup, po ashtu detajet nga llogarite bankare R...B..., të gjitha te përbëra sipas urdhëresës se Gjykatës PPN.nr. 119/2013; Qarkullimi për te akuzuarin Xh.A N.. Prishtinë, raporti i llogarisë bankare për kontribute ne SHPK ne N.. Bankë, pastaj K... KS- SHPK, N.. Prishtinë, qarkullimi i llogarisë se F.A, ne Rraiffeisen Bank, qarkullimi i llogarisë n banke N.. ne emër të A.A; Qarkullimi i llogarisë N.. ne llogarin NPH Pranvera, ekspertiza dt.27.06.2021 nga ekspertet financiar U.S dhe H.S.

Në seancën e dt.27.09.2023 janë administruar këto prova materiale të siguruara nga Komuna e Prishtinës dhe Ujësajllësi Prishtina; Përgjigja e KRU Prishtina e dt.27.07.2023, nëpërmes e-mail adresës nga B.E; Përgjigja e KRU

Prishtina e dt.22.03.2010 ku është thënë se japin pëlqim për kushtet e pjesërishme; Aktvendimi i Komunës së Prishtinës i dt.07.05.2012 me numër dhe kopja e planit e bashkangjitur; Aktvendimi i Komunës së Prishtinës i dt.12.03.2013 me numër; Aktvendimi i Komunës së Prishtinës i dt.25.06.2010, për caktimin e kompenzimit për rregullimin e tokës ndërtimore; Përgjigja e Komunës së Prishtinës e dt.01.08.2023, dhe përgjigja e dt.14.08.2023 nepërmas e-mail adresës nga N.K; Vendimi i dt.26.06.2018 me numër 05-351/02-0317172/17 dhe kopja e planit e bashkangjitur bashkë me dispozitat urbanistike të ndërtesës në parcelën kadastrale në sistemin koordinativ Kosova ref. 01; Dhënia e kushteve teknike nga kompania e Ujësjetllësit rajonal i dt.26.10.2017.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarës E.B se gjykata, duke mos konsideruar fare lejen urbanistike e cila nuk lëshohet pa kushtet teknike, ku në planin për ndërtim ishin paraparë të ndërtoheshin katër objekte, për të cilat edhe mirret kjo leje dhe fillohet ndërtimi, gjatë punimeve haset në gypin për të cilin U... R...i Prishtinës njofton në vitin 2010 ku pronarët e tokave pas shpërfaqjes se problemit duke e anashkaluar investitorin këtu të pandehurën bëjnë krekës në ujësjetllës për këtë gyp, ndërsa gjykata vetëm konstaton se E.Bka qenë e njoftuar lidhur me gypin, pra provat e kërkuara nga këto dy institucione vetëm sa e shfajësojnë E.B, e jo fajësojnë për veprën penale të mashtrimit, e si rrjedhojë dhe veprën penale të shpërlarjes së parave.

Fillimisht është fakt se e akuzuara ka qenë e njoftuar me ekzistimin e gypit të ujësjetllësit këtë e kanë pohuar edhe pronarët e tokave, për të cilin e akuzuara kishte premtuar se do ta heq. Në anën tjetër nga shkresa e ujësjetllësit KRU P..... nr.271 i dt.22.03.2010 rezulton se kishte dhënë pëlqim për ndërtimin e objektit A1 dhe A4, ndërsa për objektin A2 dhe A3 nuk kishte dhënë pëlqim, por mund të ndërtohej nëse do të largohej 5 metra në të dy anët e gypit dhe i jep sugjerim që ti drejtohet komunës. Prandaj pretendimi se gypi ishte pengës për ndërtim gjykata e shkallës së parë ka sqaruar se nuk ishte i bazuar, kurse për ndërrim e lokacionit për të cilën pretendon e akuzuara që nuk ka mundur të ndërtoj për shkak të kontestit pronësor që kishte, rezulton se nuk kishte kushte urbanistike dhe as që ishte zhvilluar ndonjë procedurë. Megjithatë për kundër kësaj e njëjta të gjithë të dëmtuarave u kishte thënë se i kishte kushtet urbanistike dhe së shpejti do të fillonte ndërtimi pasi që ka ndërruar lokacion, pra e njëjta kishte vazhduar me lidhjen e kontratave dhe vazhdimin e disa nga atyre ekzistuese pa pasur kushtet urbanistike tani për lokacionin e dytë.

Si rrjedhojë e të lartcekurave e akuzuara E.B nuk kishte mjete të veta, përveç mjeteve të paguara nga të dëmtuarit në xhirollogarinë e kompanisë “V..O...”, dhe xhirollogarinë e të akuzuarës Estrida, në fillim disa të hyra nga kompania “E..” dhe një pjesë të paguara kesh pasi që kishin lidhur parakontrata për blerje të banesave, andaj të gjitha këto transfere dhe konvertime të

pasurisë ishin bërë nga mjetet e realizuara nëpërmjet aktivitetit kriminal përkatësisht si rezultat i veprës së mashtrimit. Gjithashtu të akuzuarit E.B, XH.A, V.O kishin dijeni se pasuria e cekur rezultonte nga aktiviteti kriminal, pasurin e cekur si në dispozitiv e kishin transferuar dhe konvertuar me dijeninë e tyre, andaj në veprimet e tyre janë plotësuar elementet e veprës penale në bashkëkryerje në raport me E.B Bunjaku, shpërlaja e parave.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit V.B, av.Murat Demolli, se në raport me të mbrojturin e tij për veprën penale mashtrimi asnjë provë nuk është paraqitur gjatë gjithë procesit gjyqësor se i njëjti ka qenë i përfshirë në mashtrim, për arsye se i akuzuari asnjëherë nuk ka nënshkruar ndonjë para kontratë, e as nuk ka pranuar mjete nga palët dhje se kjo është vërtetuar nga deklaratimet e palëve të dëmtuara. Janë të pa bazuara, për arsye se gjenda faktike ka rezultuar të kundërtën, pasi që është vërtetuar se i njëjti i ka dërguar të dëmtuarit të vend punishtja, po ashtu dëmtuarit në disa raste theksuan se ka qenë ViG.H prezent gjatë bisedave që kanë bërë me E.B, kurse e dëmtuara K.T në fjalën përfundimtare të saj ka theksuar se ka qenë ViG.H kur e ka dërguar deri të banka ku e njëjta e ka bërë pagesën.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit B.V, av.Fanol Krasniqi se me as një provë gjykata nuk i mbështet konstatimet lidhur me bashkëkryerjen dhe veprimet individuale të pandehurve dhe kjo paraqet konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Provat në të cilat mbështetet aktgjykimi janë në kundërshtim me përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit, ku gjykata ka marrë si kohë të kryerjes së veprës penale ditën e arrestimit të akuzuarve, përveç kësaj nuk ka kontratë në të cilën ka nënshkruar ose ka qenë B.V, sepse ai nuk ka pasur rol dhe as pozitë që të njëjtin do ta bënte faktor.

Theksimet e tilla nuk qëndrojnë për shkak se nga deklaratat e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve është vërtetuar se të akuzuarit B.V dhe V.B i kishin dërguar në vende punishte të dëmtuarit, kishin qenë prezent gjatë bisedave dhe pikërisht të akuzuarit B.V dhe V.B kanë qenë personat e parë që kanë ditur që ndërtimi nuk po bëhej, për arsye se që të dy i kanë dërguar të dëmtuarit të vendi ku pretendohej të ndërtohej duke i prezantuar vendin, për me tepër i akuzuari B.V thekson vet se ka qenë mbikëqyrës i vend punishtes.

Po ashtu pretendimi se gjykata nuk ka vlerësuar gjendjen faktike lidhur me pengesat gjatë punimeve, sidomos të pranisë së gypit të ujësjellësit, e po ashtu nuk është vlerësuar fare gjendja

faktike lidhur me shpenzimet e ndërtimit, e materialit ndërtimor, administrative apo të vetë kompanisë.

Lidhur me këtë pretendim janë dhënë arsye se parashtruesit e kërkesës kanë qenë në njohuri për ekzistimit të gypit të ujësjellësit dhe përmasat që kishte dhe me për kundër kësaj kanë vazhduar ti mbaj të dëmtuarit në lajthim se do të gjendët një zgjidhje.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit XH.A, av.Naim Rudari se gjykata gabimisht ka vërtetur se XH.A i ka mundësuar të akuzuarës E.B fshehjen e gjurmëve të pasurisë, objektin të cilën e njëjta ka filluar ta ndërtoj me mjete financiare të përfituara me aktivitet kriminal, gabimisht ka vlerësuar se E.Bka përfituara pasuri nga aktiviteti kriminal, gabimisht ka vërtetuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale të mashtrimit dhe krimi i organizuar, po ashtu gabimisht ka vërtetuar se XH.A ka bërë krim pasi që ka pranuar një autorizim të vërtetuar nga Gjykata, si dhe gabimisht ka vërtetuar se tek i akuzuari qëndron dashja dhe dijenia e tij që në bashkëkryerje kanë fshehur dhe transferuar objektin A1 që ishte në ndërtim e sipër.

Pretendimet e lartcekura nga provat e administruar rezultojnë të jenë të pa bazuara, për arsye se nga këto prova gjykata e shkallës së parë e ka ardhur në përfundim të drejtë dhe ligjor se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën edhe janë shpallur fajtor.

Përkitazi me veprimet e ndërmarra nga i akuzuari Xh.A në deklaratën e tij të dhënë në prokurori kishte thënë se E.B në vitin 2008 i ka kishte dhënë 400.000 euro avancë për banesa. Dhe sipas marrëveshjes E.B nuk i ka asgjë borxh mirëpo i ka borxh vetëm kompania “ A.G“ 600 metra katrore, çka do të thotë se nuk e konteston që e akuzuara E.B, kishte marr autorizim për prishje të marrëveshjes për pronar të tokave. Po ashtu i njëjti kishte theksuar se në vitin 2008 e ka njohur E.B dhe rastësisht janë takuar në një lokal dhe ajo i ka treguar se është duke punuar rreth kompleksit të banesave në lagjen Mati dhe është në negociata për patundshmëri në Veternik. Pastaj është takuar disa here me të, dhe ajo i'a kishte kërkuar 250.000 euro, për të mos i dështuar projekti në Veternik deri sa banka të i'a lëshon kredinë. Pastaj i'a ka dhënë edhe disa herë 100.000 euro, 30.000 euro, 70.000 euro, 10.000 euro, 3.000 euro dhe se nga këto 350.000 euro E.Basnjë cent nuk ja ka kthyer me arsyetim se në Veternik i ka dështuar plani. Pastaj e kishte filluar me ndërtimin e objektit në Mati 1. Mirëpo sa i përket deklaramit të tij rreth shumave të lartcekura nuk kishte asnjë provë që i akuzuari XH.A të akuzuarës E.B i'a kishte dhënë shumen prej 350 ose 400 mijë euro, për kundër faktit se i njëjti në deklaratat e dhëna në procedura paraprake kishte deklaruar se do i sjell provat por që nuk i kishte sjell asnjë herë, po

ashtu i njëjti nuk kishte as dëshmi nga banka për dallim nga të dëmtuarit të cilët i kanë paraqitur dëftesë pagesat për deponimet që i kanë bërë në bankë. Edhe pse i njëjti ka deklaruar bizneset që i kishte nga provat e nxjerra nga xhirollogaria nuk kishte dëshmi se i njëjti i kishte të grumbulluara të gjitha ato të holla qoftë 250 000 mijë euro, apo 70 000 euro, mandej i njëjti ofron dëshmi edhe për bizneset e familjarëve të tij dhe xhirollogarin, ku pavarësisht të hyrave rezulton se kishte edhe shpenzime gjë që është normale sepse çdo biznes përveç të hyrave ka edhe shpenzime, megjithatë kjo nuk ishte relevante për gjykatën sepse i njëjti nuk posedonte dëshmi se ato të ardhura ia kishte dhënë E.B, madje i njëjti gjatë deklaratave të tij nuk është në gjendje të përshkruaj saktë kur ia kishte dhënë dhe sa ishte shuma e saktë e atyre të hollave ashtu siç nuk është në gjendje të argumentoj arsyen e dhënies së tyre. Në relacion me të gjatuarat e lartcekura deklaratës së përbashkët të tyre gjykata e shkallës së parë me të drejte çmoi si jo të besueshme. Lidhur me atë se pse kishte ndërmjetësuar në rastin me mes të E.B dhe pronarëve të tokave, i njëjti një herë ka theksuar se e njeh edhe E.B edhe pronaret e tokave, pastaj si arsye cekë se kishte hyrë në këtë sepse donte ti tërhiqte të hollat. Mbi këtë bazë rrjedh se i njëjti kishte dijeni për obligimin e E.B ndaj palëve të treta sepse kjo rezulton nga deklarata e përbashkët me shkrim dhe kishte pranuar që objekti i ndërtuar deri në katin e pesë të transferohej në emër të tij, andaj në raport me gjendjen faktike pretendimet e mbrojtjes rezultojnë të jenë të pa bazuara.

Kurse pretendimi se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar faktin se E.B kishte qenë punëtore në Reiffeisen Bank, se XH.A ia kishte dhënë borxh shumë prej 400.000€ me kusht që të kompensohet në ndërtim, nuk ka vërtetuar se E.B nuk ka qenë e vetme në ndërtim, por kishte lidhur kontratë për bashkëpunim me pronarët e tokave, nuk ka vërtetuar faktin se e njëjta kishte ndërmarrë veprime konkrete në teren, e po ashtu faktin se e njëjta ka pasur vështirësi për të përfunduar atë projekt pasi që kishte pasur disa ngecje, nuk ka vërtetuar as faktin se dëshmitari D.B i cili kishte vazhduar projektin e ndërtimit së bashku me pronarët e tokave i njëjti në deklaratimet e tij ka thënë se evitimi i problemit me gypin ka zgjatur 6-7 vite, po ashtu faktin se disa nga blerësit vullnetarisht kishin prishur kontratat. Janë pretendime të cilat konsistojnë në përgjigjet e lartcekura.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit V.O, av.Ramiz Krasniqi se nuk jepet përgjigje se si ishte e mundur të bëhet pastrimi i parave nëse E.B gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011, V.O i ka dërguar para përmes Wester Unionit shumë prej 16.000 euro, e të cilin fakt nuk e konteston as E.B dhe as V.O, mirëpo është kontestuese se cili do të ishte argumenti juridik se V.O e ka ditur se E.B po u marrka me aktivitete kriminale dhe se këto para i'a ka dërguar me qëllim që të njëjtat ti

fshehë apo maskoj, dhe nga provat e administruara nuk del kjo që e thotë aktgjykimi, ku dhe kemi një provë të administruar nga e cila thuhet se transaksioni është bërë në mes të E.B dhe V.O përmes Wester Unionit sikurse në faqen 132 të aktgjykimit të atakuar.

Kolegji vëren se nga faktet e çështjes nga provat e proceduara është konstatuar se E.B me V.O kishin bashkëpunuar me qëllim të maskimit dhe fshehjes së pasurisë. Nga raportet e bankës dhe dëftesë pagesat e bankës të cekura më lartë të akuzuarit i ishin transferuar para, dhe neper mes xhirollogarisë Wester Union kishte pranuar mjetet financiar në vlere prej 16.000 euro, kohë pas kohe, po ashtu i njëjti kishte pranuar shumën e të hollave në vlere prej 14.600 euro nga i dëmtuari. Po ashtu i njëjti kishte pranuar të regjistrohet vetura në emër të tij Xhip Hundaj X 55 në vlere prej 35.300 euro, si dhe një truall prej 5 ari në fshatin Ll....

Po ashtu nga shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë se E.B ka lidhje me këtë truall, se e njëjta këtë troll i'a ka blerë V.O, pasi që e njëjta edhe ka deklaruar se “as nuk i kam blerë trollë V.O, e as nuk e di dhe as që kamë qenë ndonjë herë në këtë troll”, dhe se gjykata e ngatërron parcelën e blerë nga V.O në fsh.Ll.... me parcelën në lagjen Qëndresa, e të cilat lagje kanë një distancë së paku 15 kilometra. Trolli në sipërfaqe prej 0,5.21 ari që gjendet në fsh. Ll.... është blerë nga N.K dhe se kontrata në mes të shitësit N.K dhe blerësit V.O është vërtetuar në gjykatë, të cilën troll e ka blerë në vitin 2007 para se ta njoh E.Bn, por kontratën me shitësin e ka lidhur me vonë.

Kolegji këto pretendime i çmon si të paqëndrueshme, fillimisht ngatërrimet e tilla mund sa i përket lokacionit siç ka cekur edhe vetë mbrojtja mund të jenë evident si pasoj e lëshimeve teknike, megjithatë një rrethanë e tillë është pa kontestueshëm se behet fjalë për trollin në fshatin Ll...., ndërsa pretendimi së është blerë në vitin 2007 është i pa bazuar, pas që nga kontrata e shitblerjes rezulton se i njëjti është vërtetuar në emrin e tij në vitin 2012.

Marr parasysh të gjitha provat e administruara gjykata e shkallë së parë ka ardh në përfundim të drejtë dhe ligjor se prona në fshatin Ll.... është blerë nga parat e fituara nga aktiviteti kriminal dhe ishte regjistruar në emër të V.Ot me dt.20.02.2012 me qëllim të maskimit dhe fshehjes, si rezultat i kësaj rrjedh se akuzuari ishte në dijeni për të hollat që e akuzuara E.B kishte përfituar nga mashtrimi i të dëmtuarve dhe e dinte se të hollat ishin marrë në emër të ndërtimit të banesave nga se kishte qenë prezent kur e dëmtuara A.M.K i kishte kërkuar të hollat për shkak të mos ndërtimit, e po ashtu edhe vet kishte deklaruar se e kishte shoqëruar E.B pasi e kishte të dashur dhe e kishte drejtuar automjetin të cilin kishte pranuar të regjistrohej në emër të tij.

Për rrjedhojë, Gjykata e Apelit e Kosovës nga arsyet e shpjeguara më lartë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike.

Të gjeturat për shkeljen e ligjit penal

Pretendimi i mbrojtësit të akuzuarës E.B, av.Liridon Tafa se shkelja e ligjit penal qëndron sa i përket kualifikimit juridik të veprës penale mashtrimi, pasi që e njëjta akuzohet mbi bazën e supozimit të pa provuar dhe mbi bazën e paragjykitimit, ndërsa për vepre penale shpërlaja e parave me asnjë provë prokuroria nuk e provon se pasuria në fjalë të këtë buruar nga ndonjë aktivitet kriminal.

Pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit V.B, av.Murat Demolli, se është shkelur në mënyrë flagrante ligji penal, sepse i akuzuari është akuzuar për veprën penale të cilën nuk e ka kryer, prokuroria speciale ka ngritur aktakuzën për veprën penale krim i orG.Hzuar nga neni 274 par.1 lidhur me par.2 e në raport me E.B par.3 të KPK-së (i vjetër) lidhur me veprën penale mashtrimi nga neni 261 par.1 lidhur më par.2 të KPK-së (i vjetri), ndërsa gjykata ka marrë për bazë kodin e ri penal i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2013, andaj kur gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, edhe shkeljet e ligjit janë të pa shmangshme.

Pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit akuzuari B.V, av.Fanol Krasniqi, se është shkelur ligji penal në dëmin e të akuzuarit B.V, pasi që vepra me të cilën i akuzuari ndiqet nuk është vepër penale, ngase ndërmjetësimi, shitja ose vozitja e klientëve të një biznesi prej zyrës se biznesit e deri të vendpulishte nuk është vepër penale, nuk ka elemente të veprës penale pasi që këto veprime i legalizon LMD-ja, dhe në këtë rast nëse nuk do të ishte tejkalar akuzat me rikualifikimin e veprës penale, tanimë do të arrinte parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Kjo mbështetur në faktin se të gjitha provat personale dhe materiale objekt vlerësimi dhe shqyrtimi kanë pasur kohën e kryerjes së veprës penale nga viti 2009 deri 2011, ku nuk mund të thuhet se kohë e kryerjes së veprës penale është dita e arrestimit të akuzuarit dhe se ndaj të njëjtit është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet duke e bërë rikualifikim në dëm të akuzuarit, duke shkelur kështu edhe Kushtetutën dhe të drejtat e garantuara e ligj.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit Xh.A, av.Naim Rudari se është shkelur ligji penal në kundërshtim me dispozitën e nenit 385 të KPPRK-së, sepse vepra për të cilën akuzohet i mbrojturi im nuk është vepër penale dhe se nuk është vërtetuar se kanë ekzistuar veprimet e

Xh.A të cilat do të përbënin elementet e veprës penale, përveç kësaj lidhur me këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut të ndjekjes penale.

Ndërsa pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit V.O, av.Ramiz Krasniqi se pasi që aktgjykimi ka një mori shkeljes të dispozitave të procedurës penale, kur gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, edhe shkeljet e ligjit janë të pa shmangshme.

Pretendimet e mbrojtëseve se shkelja e ligjit penal është pasojë, e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe pasojë e vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike (e kualifikimit të veprës penale, e mos kryerjes se veprës penale dhe arritjes se parashkrimit), janë të paqëndrueshme, ngase mbi bazën e fakteve të provuara, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal, kjo për faktin se në veprimet e të akuzuarve formësohen tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor, se për këto vepra penale të njëjtit janë penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarve dhe se në rastin konkret nuk kemi parashkrim të veprës penale siç është shpjeguar edhe më lartë gjatë aktgjykimit, për arsye se ekziston parakontrata edhe gjatë viti 2013, si dhe ka vazhduar mbajtja në lajthim e të dëmtuarave gjatë kësaj periudhe.

Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet mbrojtëseve të akuzuarit për një dënim me të butë nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Kështu si rrethanë lehtësuese për të gjithë të akuzuarit ka vlerësuar faktin se të njëjtit më parë nuk kanë qenë të dënuar pasi gjykata nuk ka prova për këtë, ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar shkallen e lartë të përfshirjes së të akuzuarve secilin veç e veç në raport me veprat penale për të cilat u shpallen fajtorë e veçanërisht shkallën e lartë të përfshirjes së të akuzuarës E.B, numrin e madh të personave të dëmtuar, të cilët ishin humbur kursimet dhe të ardhurat e tyre duke shprehur se do të bëhen me banesa.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka

vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara në ankesën e mbrojtëseve se vendimi nuk është i ligjshëm pasi që të akuzuarit nuk i kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar, janë pretendime të përgjithësuara dhe të pa argumentuara pasi që nga provat e lartcekura është vërtetuar se të njëjtit janë kryerës të veprave penale për të cilat janë akuzuar dhe në raport me veprimet inkriminuese dënimi i shqiptuar rezulton të jetë i drejtë dhe në kuadër të kornizave ligjore, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e Gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë të veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, rrethanave të kryerjes, pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohen të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti Special

APS.nr.5/24

Datë: 22.04.2024.

**Bashkëpunëtorja profesionale,
Syzana Goxhuli**

Anëtarët e kolegjit:

Bashkim Hyseni

Afërdita Bytyçi

**Kryetar i kolegjit,
Vaton Durguti**
